



# Europa:

Përse bëhet fjalë në  
përgjithësi?



Bashkimi Europian



Broshura “Europa: Përse bëhet fjalë në përgjithësi” si dhe udhërrëfytyesi për mësuesit që e shoqëron, gjenden në faqen e internetit si vijon:

[europa.eu/teachers-corner/index\\_en.htm](http://europa.eu/teachers-corner/index_en.htm)

[bookshop.europa.eu](http://bookshop.europa.eu)

<http://smei3.mie.gov.al/en/pages/Home>

<http://integrimi.gov.al/>

### **Komisioni Europian**

Drejtoria e Përgjithëshme për Komunikimin

Publikimet

1049 Bruksel

BELGJIKË

Botimi në gjuhën shqipe u përgatit në kuadër të projektit të asistencës teknike SMEI 3 «Mbështetje për Procesin e Integritimit Europian – faza III», financuar nga Bashkimi Europian (IPA 2010).

Dorëshkrimi përfundoi në maj 2013.

Teksti: Eckart D. Stratenschulte, European Academy Berlin

Broshura “*Europe: What's it all about?*”, fillimisht u botua në Gjermani nga ‘actionEuropa’ (Qeveria Federale, Parlamenti Europian dhe Komisioni Europian), me titullin ‘Europa das Wissensmagazin für Jugendliche’. Ajo u ripunua dhe u përditësua nga Komisioni Europian, Drejtoria e Përgjithëshme për Komunikimin. Faqosja origjinale u bë nga Zeitbild Verlag und Agentur für Kommunikation, Berlin/MetaDesign AG, Berlin. Fotografitë e të rinjve Alice, Jello, Patricia, Motian dhe Janette u realizuan gjithashtu nga Zeitbild.

Luxembourg: Zyra e Publikimeve të Bashkimit Europian, 2013.

ISBN 978-92-79-29207-1

doi:10.2775/11551

2013 — 56 fq. — 21 x 29.7 cm

© Bashkimi Europian 2013

Riprodhimi autorizohet.

# Europa:

## Përse bëhet fjalë në përgjithësi?



## Përmbajtja

### 1 Europeanë në jetën e përditëshme 4

Përhëndetje. Ne studiojmë në shkollën e mesme 'Robert Jungk' në Berlin dhe do t'ju shoqërojmë deri në fund të broshurës.



### 2 Bashkimi European—ç'kuptim ka kjo saktësisht? 10

Bashkimi European përbëhet nga 28 shtete që kanë bashkuar forcat e tyre për të ndërtuar një jetë më të mirë.

### 3 Si funksionon Bashkimi European? 16



Shpesh herë BE-ja krahasohet me një shtet, por ajo është organizuar krejtësisht ndryshe.

### 4 Çfarë bën BE-ja saktësisht? 24

Disa njerëz thonë se BE-ja nuk bën aq sa duhet; te tjerë thonë se ajo ndërhyn në çdo gjë. Kush ka të drejtë?



### 5 Europa shkon përpara — zgjerimin e Bashkimit European 34

Bashkimi European u krijua nga gjashtë vende, por vazhdimisht ka synuar të përfshijë gjithë Europën — domethënë se ai është i hapur për pranimin e anëtarëve të rinj.



### 6 Europa dhe bota në përgjithësi 40

Ne europeanët nuk jemi të vetmit në botë. Ne gjithashtu nuk përbëjmë shumicën e popullsisë së botës, por kjo jo dhe për shumë kohë.

### 7 E ardhmja e Europës 46

Çfarë kemi tjetër? Le të shohim detyrat që i dalin BE-së në shekullin e 21-të.



# 1

## Europa në jetën e përditshme



"Përsëritet. Ne jemi Alice, Jello, Patricia, Motian dhe Janette dhe studiojmë në shkollën e mesme 'Robert Jungk' në Berlin, një shkollë gjithëpërfshirëse me mësim për Europën në gjermanisht dhe polonisht. Ju do të na ndeshni përsëri në këtë broshurë, sepse ne japim disa këshilla të rëndësishme, ushtrime interesante, disa lojëra të vogla me pyetje-përgjigje dhe ide për diskutim. Do ta shihni se do të zbavitni duke mësuar."

“Europa është diku gjetkë”. Sigurisht që kjo nuk ka kuptim, sepse si qytetarë të BE-së për ne Europa është shtëpia jonë. Kështu që ne jemi pikërisht në qendër të saj. Por shumë njerëz e ndjejnë veten se janë shumë larg Bashkimit European, domethënë nga grupimi i vendeve europiane që duan të ndërtojnë një të ardhme së bashku. Qëllimi i këtij kapitulli është që të njihemi pak më shumë me Bashkimin European. Shpejt keni për ta kuptuar se Europa jemi ne.

## Ushtrim

### Sa larg është ‘Brukseli’?

Ne dëgjojmë çdo ditë për Bashkimin European në lajmet ose lexojmë për të nëpër gazeta. Megjithatë shumë njerëz nuk janë të interesuar për BE-në. Si mendoni ju, përse ndodh kjo?

- BE-ja nuk ka rendësi për jetën tonë.
- BE-ja është tepër e ndërlikuar.  
Media nuk raporton shumë për BE-në.
- Vendimi për të gjitha çështjet e rëndësishme merret më shumë nga vetë Shtetet Anëtare sesa në Bruksel apo Strasburg, pra mjafton të merresh me politikat kombëtare.
- Në përgjithësi politika është bezdisshme.



## Europa — një lojë e shkurtër

Sa vende janë në Bashkimin European?

- 12
- 15
- 25
- 28
- 30

Si zgjidhen deputetët e Parlamentit European?

- Ata nuk zgjidhen. Ata emërohen nga Kryetari i Shtetit të secilit vend me sugjerimin e Kryetarit të Qeverisë.
- Në zgjedhjet parlamentare në secilin Shtet Anëtar, sepse deputetët e Parlamentit European janë gjithashtu deputetë të parlamenteve të tyre kombëtare.
- Ata delegohen në Parlamentin European nga parlamentet kombëtare.
- Në zgjedhjet e përgjithshme me votim të fshehtë sikundër deputetët e parlamentit në vendet e tyre.

Sa vende të Shteteve Anëtare të BE-së përdorin euron si monedhën e tyre të zakonshme?

- Të gjithë Shtetet Anëtare.
- Gjashtë shtetet themelues.
- Trembëdhjetë vende.
- Tetëmbëdhjetë vende.

Më 2013 BE-ja shpenzoi rreth 133 miliard euro. Ç’përqindje të prodhimit të brendshëm bruto (PBB) të vendeve të BE-së mendoni se përfaqëson kjo shifer?

- 80.9 %.
- 50.2 %.
- 15.3 %.
- 0.99 %.

Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit European mbështet legjislacionin european. Ku ndodhet Gjykata?

- Në Lisbonë
- Në Bruksel
- Në Strasburg
- Në Luksemburg

## Ushtrim

### Po ju?

Interesi im për Bashkimin European është:

- shumë i madh
- i madh
- mesatar
- i vogël
- shumë i vogël
- nuk kam

sepse \_\_\_\_\_



## Ushtrim

Sa ka të bëjë BE-ja me ne?

Nëntë shembuj

Me jetën tonë	Lidhja me BE-në	Mendoj se ...		
		shumë e rëndësishme	e rëndësishme	jo e rëndësishme
Tregtia brenda Europës rritet vazhdimisht. Nga kjo rritje nuk përfitojnë vetëm korporatat e mëdha, por dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Kjo ndihmon për ruajtjen e <b>vendeve të punës</b> .	Krijimi i një tregu të vetëm europian prej 500 milion vetësh ka çuar në rritjen e tregtisë midis vendeve të BE-së nga 800 miliard euro në 2540 miliard në vitin 2010.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<b>Telefonatat</b> janë bërë shumë më të lira këto vitet e fundit.	BE-ja ka liberalizuar tregun e telekomunikacioneve që do të thotë se janë prishur monoqet kombëtare dhe i është hapur rruga konkurrencës. BE-ja ndërhyr drejtpërdrejt kur konkurrenca është e pamjaftueshme. Për shembull, telefonat nga celularët janë bërë më të lira, si rezultat i ndërhyrjes së Parlamentit Europian dhe Komisionit Europian.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Vitet e fundit <b>fluturimet</b> kanë çmime më të arsyeshme, prandaj më shumë të rinj dhe familje me fëmijë e përballojnë udhëtimin me avion.	Edhe në këtë fushë janë hequr monoqet dhe është lejuar konkurrenca. Tani, për shembull, mund të fluturosh nga Hungaria në Francë me një linjë britanike. Tashmë pasagjerët kanë më shumë të drejta. Në rast se mbeteni në aeroport, sepse avioni ka qenë i mbingarkuar ose nuk arrini dot në një takim të rëndësishëm për shkak të vonesës së madhe të shkaktuar nga linja ajrore, atëherë ju mund të kompensoheni për vonesën.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Me jetën tonë	Lidhja me BE-në	Mendoj se ...		
		shumë e rëndësishme	e rëndësishme	jo e rëndësishme
<b>Periudha e garancisë</b> për prodhimet e konsumit, si ato elektronike, tani është 2 vjet. Kjo do të thotë që në rast se p.sh. aparati celular nuk punon pas 1 viti, ai riparohet ose zëvendësohet falas.	Normat europiane kanë krijuar afate kohore të njëjlojta. Garancia është e vlefshme në të gjithë Europën. Nuk ka rëndësi në ç'vend të BE-së është blerë malli.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<b>Ndotja e mjedisit nuk nje kufij.</b> Ne të gjithë kemi nevojë të marrim frymë, prandaj kuptohet që ajri i pastër është shumë i rëndësishëm dhe vitet e fundit ai është përmirësuar.	BE-ja ka vendosur standarde të detyrueshme në të gjithë Europën për ajrin që ne thithim dhe shtetet anëtare duhet t'i zbatojnë këto standarde.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<b>Uji</b> është i rëndësishëm sepse ne jo vetëm e pijmë, por edhe lahem me të. Prandaj <b>cilësia</b> e tij është vendimtare. Në BE, qytetarët duhet të ndjehen të sigurt, kur pijnë ujë nga rubineti.	Ka 10 vjet që BE-ja ka vendosur standarde të cilësisë, të cilat duhet të zbatohen nga të gjitha shtetet anëtare.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Është shumë e lehtë sot <b>të udhëtosh në Europë.</b> Nuk ka më kontrole kufitare ndërmjet shumicës së vendeve europiane.	Marrëveshja Shengen është bërë e panevojshme për kontrollin kufitar midis shteteve anëtare. Kjo do të thotë që p.sh. mund të udhëtosh nga Kepi i Veriut të Norvegjisë deri në Sicili pa kontroll kufitar.  Në Marrëveshjen Shengen nuk marrin pjesë Mbretëria e Bashkuar, Irlanda, Bullgaria, Kroacia, Qiproja apo Rumania.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Qytetarët e BE-së kanë mundësi të punojnë në një vend tjetër europian, ashtu si edhe në vendin e tyre. Gjithkush mund të vendosë <b>ku dëshiron të jetojë, apo ku të kërkojë punë</b> në BE.	BE-ja ka realizuar lirinë e lëvizjes brenda tregut të saj të brendshëm. Dikush nga Viena mund të punojë në Bruksel ose Romë, Londër apo Varshavë, njëjloj si në Linz apo Insbruk.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Mundet që për fat të keq <b>të sëmuresh ose të pësosh aksident,</b> madje edhe kur je me pushime. Prandaj është mirë të dish që si qytetar i BE-së, mund të mjekohesh falas dhe pa problem në çdo vend të BE-së.	Vendet e BE-së mbulojnë sigurimin shëndetësor të njëri-tjetrit. Ndaj mjafton të paraqitësh 'Kartën Europiane të Sigurimit Shëndetësor' apo një dokument të barazvlefshëm për t'u mjekuar. E vetmja gjë që mbetet është të mendosh për veten dhe jo për procedurat burokratike në një vend, gjuhën e të cilit ti mbase as nuk e flet.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Ushtrim

Çfarë përgjigjesh kanë dhënë shokët e klasës?

Shikoni përgjigjet e njëri-tjetrit dhe diskutoni rezultatet.

Ushtrim

BE-ja në shtëpi

Mendoni për jetën e përditshme dhe familjen tuaj. Ku hyn BE-ja në këtë rast? Mendoni disa shembuj, si ushqimi dhe paratë, shkolla dhe studimet, udhëtimet dhe puna.

# Arsimi dhe studimet në vende të tjera të BE-së

► Nga lëvizja e lirë përfitojnë jo vetëm punëtorët, por edhe turistët, pensionistët, studentët dhe stazhierët.

Për studentët lëvizja sigurohet nga programi 'Erasmus' i BE-së. Ai u jep studentëve mbështetje financiare dhe organizative për qëndrimin në një universitet partner European. Ka një sistem European të pikëve që mundëson kreditimin e pikëve të fituara jashtë vendit në studimet që bëjnë në vendin e tyre, në mënyrë që koha e shpenzuar jashtë vendit të mos jetë kohë 'e humbur'.

Për stazhierët profesionistë ka një program të veçantë të quajtur 'Leo-

nardo da Vinci', i cili siguron para dhe mbështetje organizative për një punësim jashtë vendit. Rreth 75.000 qytetarë të rinj të BE-së përfitojnë në këtë mënyrë çdo vit që të plotësojnë pjesërisht kualifikimin e tyre në një vend tjetër. Programi realizohet në partneritet me kompani dhe institucione, të cilat më pas shpallin projektet, në të cilat të rinjtë mund të aplikojnë (stazhierë dhe nëpunës të rinj, por edhe të rinj të papunë).

Në fillim mund të duhen shumë përpjekje për t'u përfshirë në një projekt të tillë në një vend tjetër. Por përvoja që fitojnë të rinjtë i justifikon plotësisht këto përpjekje.

Alice: 'Rreth 2.5 milion studentë e 3.000 stazhierë kanë qenë në një vend tjetër të BE-së nga viti 1987 deri më 2012 një ose dy herë, në kuadrin programit Erasmus. Në këtë bashkëpunim akademik kanë marrë pjesë mbi 3.000 universitete dhe kolegje të 28 shteteve anëtarë të BE-së dhe të pesë vendeve të tjera.'

## Ushtrim

A mund ta imagjinoni të kaloni një sezon apo një vit jashtë, ose të bëni një kurs të plotë në një vend tjetër?

Bëni një listë të argumenteve 'pro dhe kundër'.  
Cila palë fiton?

### Argumentet për një periudhë studimesh jashtë

1.

2.

3.

4.

### Argumentet kundër një periudhe studimesh jashtë

1.


2.

3.

4.

Tani krahasoni rezultatet tuaja dhe diskutojini ato.





Ushtrim

## Simbolet Europiane

A i njihni simbolet dhe objektet e mësipërme? Ku mund t'i gjeni ato? Mendoni se ç'kanë të bëjnë ato me Europën dhe me jetën tonë.

# Europeanë në jetën e përditshme

► Në fillim pyetëm përse shumë njerëzve Europa u duket aq e largët. Njerëz të ndryshëm mund të kenë arsye të ndryshme.

Por duke e parë çështjen më nga afër, del se Europa apo më mirë Bashkimi European është në të vërtetë përreth nesh, duke prekur jetën tonë në shumë fusha.

Të fillojmë nga para: Euroja është një monedhë e përbashkët; jo të gjitha vendet e kanë pranuar atë, por gjysma e tyre po. Kur shkojmë me pushime p.sh. në Austri, Francë ose Spanjë, ne paguajme me këtë monedhë. Madje edhe në vende ku euroja nuk përdoret, ajo përsëri pranohet si një monedhë globale e fortë. Me euron ne na mirëpresin kudo në botë.

Shumë njerëz që janë mësuar të udhëtojnë rëndom kudo në Europë zor se e kanë vënë re këtë gjë. Por nuk ka shumë kohë që gjërat ishin ndryshe. Atëherë kishte kontroll pasaportash dhe radhë në kufi dhe doganierët donin të

dinin me saktësi çfarë blerjesh kishit bërë.

Fluturimet u bënë shumë më të lira, edhe në BE, kur u hoq dorë nga monopole kombëtare. Kjo do të thotë që nuk kishte më linja kombëtare për secilin vend, duke mbajtur monopolin për disa linja si dhe çmime të larta. Sot çdo linjë ajrore brenda BE-së mund të fluturojë ku të dojë. Kështu p.sh. mund të rezervosh një fluturim nga Danimarka për në Spanjë me një linjë irlandeze.

Fakti që fluturimet në BE janë të sigurta është edhe si rezultat i standardeve të përbashkëta të sigurisë të përcaktuara nga BE-ja për të gjitha shtetet anëtare. Ndaj kompanitë që operojnë pa i plotësuar kushtet themelore të sigurisë, nuk lejohet të hyjnë në hapësirën europiane.

Shumë nga këto rregulla janë vendosur për shkak të 'tregut ndërkombëtar'. Nëse dëshironi të keni një treg të vetëm ku njerëzit të blejnë

dhe të prodhojnë mallra ku të duan dhe kur të duan, duhet të ketë rregulla të përbashkëta.

Edhe forcat policore në BE bashkëpunojnë nga afër me njëra-tjetrën. Një organ i BE-së që quhet Europol, bashkërendon të dhënat. Ata nuk janë superpolicë, që bredhin në Europë të armatosur, por forca policore të shteteve, që mbledhin informacion për krimin dhe kriminelët dhe e vënë atë në shërbim të forcave policore dhe të BE-së. Fjala është për krime të rënda. Europolin nuk e shqetëson parkimi i paligjshëm, por trafikantët e qënieve njerëzore dhe të drogës, krimet seksuale, sekserët e makinave të vjedhura, shkelësit e internetit, që shfrytëzojnë hapjen e kufijve për veprimtarinë e tyre të pandershme.

Ndotja e mjedisit nuk ndalon në kufi. Prandaj rreziku i ndotjes mund të përballet vetëm kolektivisht. Kjo na prek të gjithëve sepse të gjithë thithim ajër, pimë dhe


konsumojmë ujë, përdorim drithërat që mbillen në fushë. Mbrojtja mjedisore Europiane ka përcaktuar standarde dhe një vend i BE-së nuk mund të përfitojë avantazh ekonomik kundrejt një tjetri duke injoruar rregullat mjedisore dhe duke prodhuar mallra më të lira.

Kërkesa për drejtësi në tregun e vetëm European ruan vendet e punës sepse parandalon konkurrencën e pandershme.

Shumë njerëz refuzojnë të përdorin ushqime të përpunuara gjenetikiisht. Por si mund ta dimë nëse cornflakes nuk janë prodhuar nga misri i përpunuar gjenetikiisht? BE-ja i ka detyruar të gjithë prodhuesit të vendosin qartë në etiketa përbërësit e ushqimeve përfshirë ato të përpunuara gjenetikiisht.

Ne mund të vazhdonim, por tani është e qartë se Europa jemi ne të gjithë dhe se Europa na prek të gjithëve.

# Bashkimi European — çfarë do të thotë kjo saktësisht?



Bashkimi European përbëhet nga 28 shtete që kanë bashkuar forcat e tyre për të ndërtuar një jetë më të mirë.  
Cilat vende bëjnë pjesë në Bashkimin European dhe pse janë bashkuar ato?

## Ushtrim

### Cilat janë shtetet anëtare?

Këtu është një listë vendesh. Ato janë të gjitha në Europë, por nuk bëjnë të gjitha pjesë në Bashkimin European. Gjeni cili vend është në BE dhe shënojini ato në listën e mëposhtme, të renditura sipas datës kur janë pranuar.

Andora, Austria, Belgjika, Bosnja dhe Herzegovina, Bullgaria, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Greqia, Gjermania, Holanda, Hungaria, Irlanda, Islanda, Italia, Kroacia, Letonia, Lihtenshteini, Lituania, Luksemburgu, Malta, Mali i Zi, Mbretëria e Bashkuar, Moldova, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Qipro, Republika Çeke, Republika ish Jugosllave e Maqedonisë, Rumania, Serbia, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia, Shqipëria, Ukraina, Vatikani, Zvicra.

Shtetet Anëtarë në BE

Vendi	Pranimi	Popullsia	Kryeqyteti
	Anëtar themelues 1952/1958		
	Anëtar themelues 1952/1958		
	Anëtar themelues 1952/1958		
	Anëtar themelues 1952/1958		
	Anëtar themelues 1952/1958		
	Anëtar themelues 1952/1958		
	1973		
	1973		
	1973		
	1981		
	1986		
	1986		
	1995		
	1995		
	1995		
	2004		
	2004		
	2004		
	2004		
	2004		
	2004		
	2004		
	2004		
	2004		
	2004		
	2007		
	2007		
	2013		

## Ushtrim

### Çfarë dini tjetër ju për këto vende — ose çfarë mund të mësoni?

Lutemi mblidhni informacion në grupe dhe paraqiteni atë në mënyrë sistematike. Ç'dini ju për ushqimin, kulturën dhe gjuhët në këto vende? Bëni një dosje për vendet që ju i njihni më mirë apo për të cilat keni gjetur më shumë informacion.



## Europa — një lojë e shkurtër

1. Cili është kryeqyteti më i vogël në BE dhe sa banorë ka ai?
2. Cili kryeqytet i BE-së është më i ftohti, d.m.th. që ka temperaturat mesatare më të ulta në janar?
3. Cili është mali më i lartë në Bashkimin European?
4. Me cilat dete kufizohet Bashkimi European?
5. Në cilat vende të BE-së mbretërojnë monarkë, p.sh. një mbret apo mbretëreshë?
6. Sa gjuhë zyrtare ka në Belgjikë?
7. Cili vend ka popullsinë më të madhe në Bashkimin European?
8. Cili vend i BE-së ka sipërfaqen më të madhe?
9. Cili kryeqytet në Bashkimin European është më lindori?

Pyetje e veçantë për ekspertët

10. Përse flamuri i BE-së ka dymbëdhjetë yje, në vend që të kishte një yll për çdo shtet anëtar?

# Përse Bashkimi European ka kaq shumë gjuhë zyrtare?

► Përderisa BE-ja është një organizatë demokratike, ajo duhet t'u drejtohet qytetarëve të saj, qeverive të shteteve anëtare, organeve publike, kompanive dhe organizatave të tjera në gjuhën e tyre. Njerëzit kanë nevojë të dinë se çfarë bëhet në emër të tyre. Ata gjithashtu duhet të kenë mundësinë të përfshihen aktivisht pa qënë nevoja që

fillimisht të dinë një gjuhë të huaj.

Bashkimi European nxjer gjithashtu ligje që kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me secilin në BE. Për qytetarët dhe sigurisht për gjykatat kombëtare këto ligje duhet të gjenden në gjuhën e vendit, pra duhet të botohen në secilën gjuhë zyrtare. Përdorimi i gjuhëve

zyrtare ndihmon transparencën, ligjshmërinë dhe efektshmërinë e BE-së dhe të institucioneve të saj.

Një lojë zbavitëse mbi gjuhët Europiane mund ta gjeni në faqen e internetit:  
[http://ec.europa.eu/languages/quiz/quiz\\_en.htm](http://ec.europa.eu/languages/quiz/quiz_en.htm)

## Ushtrim

### A e flisni gjuhën europiane?

Me pranimin e vendit kryeqyteti i të cilit është Zagrebi, Bashkimi European ka 24 gjuhë zyrtare. Tani formojini ato me bashkimin e fragmenteve të mëposhtme.

bull – tishtja – çek – dani – garishtja – dishtja – ang – kroa – ruma – onishtja – finlan, jishtja – kishtja – sllov – njishtja – greqi – onishtja – litu – pol – galishtja – rishtja – ishtja – sue – hunga – nishtja – lishtja – irlan – est – shtja – dishtja – ita – let – anishtja – dishtja – mal – gjerman – onishtja – portu – tishtja – nishtja – slova – shtja – frëng – lishtja – enishtja – hollan – spa – dishtja


# Fuqia ekonomike

► Vendet e BE-së nuk janë të ndryshme vetëm për nga madhësia, por disa janë më të pasur se të tjerët. Ka vende ku shumica e popullsisë është në gjendje shumë të mirë dhe të tjera ku standardi i jetesës është shumë më i ulët. Lind pyetja e natyrshme si mund të matet kjo. Sigurisht që në çdo vend ka njerëz të pasur dhe të varfër. Cilin marrim për model, shefin apo shoferin e tij, sekretaren apo mjekun e moshuar?

Statistikat ekonomike e kanë zgjidhur problemin duke parë fillimisht fuqinë ekonomike të një vendi. Çdo makinë e prodhuar në këtë vend gjatë një viti, çdo prerje flokësh nga berberi, çdo litër qumësht që shitet, shprehet në terma monetare, të cilat mblidhen.

Shumën e këtyre vlerave e quajmë prodhimi i brendshëm bruto (ose shkurt PBB). Por PBB nuk tregon shumë sa i pasur është një vend sepse ka vende të mëdhenj dhe të vegjël, prandaj kjo duhet përpjestuar me numrin e njerëzve që jetojnë në atë vend. Nga kjo del PBB-ja për frymë.


Por kjo është edhe më e ndërlikuar, nëse duam të krahasojmë shtetet që nuk kanë të njëjtën fuqi financiare, duhet të kemi parasysh që fuqia blerëse ndryshon nga vendi në vend. Kushdo që ka qenë për pushime jashtë, e di këtë. Papritur çmimet të duken shumë të larta apo shumë të ulta në krahasim me çmimet në vendin tënd. Buka kushton një euro në një

vend, por dy apo tre euro në një vend tjetër. Prandaj analistët nuk shohin vetëm të ardhurat për frymë në një vend të caktuar, por edhe ç'mund të blihet me këto para. Kjo është kryesorja. Ne e quajmë këtë 'barazia në fuqinë blerëse'. Kjo është e vetmja mënyrë si mund të krahasohen vendet me njëra-tjetrën.

Në rast se ne krahasojmë pastaj fuqinë ekonomike të vendeve të BE-së në bazën e barazisë së fuqisë blerëse, do të kemi një pasqyrë të tillë:

## Si është gjendja ekonomike e Europeanëve?

(Prodhimi i brendshëm bruto për frymë të popullsisë i krahasuar në bazë të barazisë së fuqisë blerëse më 2011)



PPB në Austri dhe Irlandë është 29% më i lartë nga mesatarja e BE-së. PPB për frymë në Itali është sa kjo mesatare, ndërsa në Rumani dhe Bullgari më pak se gjysma e mesatares së BE-së.

Dallimet në standardet e jetesës brenda BE-së do të ruhen për një kohë të gjatë, por Bashkimi European synon t'i zbusë këto dallime. Për këtë arsye vendet më të varfra të BE-së marrin financime për

të përmirësuar infrastrukturën e tyre dhe të rritin mundësitë e tyre ekonomike. BE-ja harxhon gati gjysmën e buxhetit të saj për këtë qëllim.

# Bashkimi European — të ndryshëm por të bashkuar

► Sikundër e dini BE-ja përbëhet nga vende shumë të ndryshme. Më i madhi është Gjermania me 82 milion banorë, më i vogli është Malta me 400 mijë banorë. Anëtarë janë edhe Finlanda dhe Italia, si dhe Portugalia dhe Polonia. Po të marrim hartën, shohim se sa e ndryshme është Europa. Njerëzit flasin gjuhë të ndryshme dhe përdorin tre lloje alfabetesh. Të ndryshme janë traditat, kulturat, mënyrat e të ushqyerit dhe festivalet. Përvojat e tyre historike nuk janë të njëjtoja. Shumë vende të BE-së në të kaluarën kanë luftuar kundër njëri-tjetrit, kanë pushtuar territorin e njëri-tjetrit dhe kanë ende shumë paragjykime. Por si është e mundur që pavarësisht sa më sipër 28 vende janë bashkuar?

Kjo pyetje gjen përgjigje vetëm në dritën e historisë. Pas tmerit të Luftës së Dytë Botërore, që filloi 20 vjet pas fundit të Luftës së Parë Botërore, shumë popuj thanë se një gjë e tillë nuk duhet të lejohej të ndodhte përsëri.

Kjo ide lindi nga dy armiqtë e mëparshëm, Gjermania dhe Franca, të cilat vendosën të mos i kundërvihen më njëra-tjetrës, por të jenë të bashkuara, duke ruajtur njëra-tjetrën. Udhëheqësit politikë që mbrojtën këtë koncept dhe e bënë atë realitet ishin ministri i jashtëm francez Robert Schuman (1886–1963) dhe kancelari gjerman Konrad Adenauer (1876–1967).

Organizmi i parë nga i cili lindi BE-ja ishte Komuniteti European i Qymyrit dhe Çelikut (ECSC) i krijuar më 1952, me qëllimin për të administruar kolektivisht rezervat e qymyrit. Qymyri luante atëherë rolin që luan sot nafta dhe gazi natyror, pra ai ishte burimi kryesor i energjisë. Shumë njerëz kishin frikë se

mund të kishte konflikt për këtë lëndë të parë. Në këtë mënyrë shpërndarja e qymyrit dhe rindërtimi i industrisë së rëndë u vunë nën kontrollin e një autoriteti të përbashkët, në të cilin përfaqësoheshin anëtarët e ECSC (Komuniteti European i Qymyrit dhe Çelikut). Bashkë me Gjermaninë dhe Francën ishin edhe Italia, Belgjika, Holanda dhe Luksemburgu. Parimi i ECSC ishte fare i thjeshtë: secili vend kishte zërin e tij në çështjet e çdo vendi tjetër dhe ishte i gatshëm të pranonte vërejtjet e tyre. Asnjëri nuk mund të punonte apo vepronte fshehtas kundër tjetrit, por ato mund ta rindërtonin Europën bashkërisht. Në të njëjtën kohë partnerëve u iku frika nga njëri-tjetri dhe paqja mund të sigurohej në Europë. Presidenti i parë i Komisionit të Lartë të ECSC ishte francezi Jean Monnet (1888–1979), i cili ishte gjithashtu një nga nxitësit kryesorë të integritimit.

Disa vite më vonë ky parim u shtri në të gjithë ekonominë nëpërmjet Komunitetit Ekonomik European. Kjo u vendos më 1957 me Traktatin e Romës dhe hyri në fuqi më 1958

Kështu armiqësia e ndërsjellë u kthye në një bashkëpunim, i cili ishte jashtëzakonisht i suksesshëm. Komuniteti European bëri hapa të rëndësishëm ekonomikë. Nuk është habi që gjatë viteve shumë vende të tjera janë bashkuar.

Më 1973 u bashkuan Mbretëria e Bashkuar, Irlanda dhe Danimarka, pastaj u bashkua Greqia më 1981 dhe Spanja e Portugalia më 1986. Pas përfundimit të konfliktit lindje-perëndim rruga ishte e hapur për shtetet neutralë si Austria, Suedia dhe Finlanda, të cilët u bënë anëtarë më 1995, dhe për vendet që më parë bënin pjesë në kampin e ish-Bashkimit Sovjetik.

Viti 2004 ishte viti i zgjerimit të lindjes, kur u pranuan Estonia, Letonia, Lituania, Polonia, Republika Çeke, Sllovakia, Hungaria si dhe Slovenia, Malta dhe Qiproja. Më 2007 zgjerimi vazhdoi me pranimin e Bullgarisë dhe Rumanisë, dhe më 1 korrik 2013 Kroacia u bë anëtar i 28-të i BE-së.



Ndonëse ndonjëherë ka pasur diskutime dhe mosmarrëveshje të rëndësishme, parimet themelore të BE-së kanë mbetur të pandryshuara: ruajtja e paqes midis shteteve anëtarë, bashkëpunimi me përfitim të ndërsjellë dhe veprimet e jashtme të përbashkëta në rritje. Rëndësia e punës së BE-së për paqen, demokracinë dhe të drejtat e njeriut në Europë për më shumë se 50 vjet u vlerësua nga Komiteti i Çmimit Nobel më 2012 kur Bashkimit European iu dha Çmimi Nobel për Paqen. BE-ja ishte grupi i parë i vendeve të botës që u nderua me këtë çmim.

## Historia e fotografive të BE-së

Shiko fotografitë nga historia e Bashkimit European sipas kapitujve përkatës.




©EU



©EU



©EU



1. Pas Luftës së Dytë Botërore shumë qytete në gjithë Europën ishin kthyer në gërmadha. Këtu është Frankfurti në Gjermani.

2. Një akt simbolik: Jean Monnet (d), Presidenti i Komisionit të Lartë të Komunitetit European të Qymyrit dhe Çelikut (ECSC), tregon bllokun e parë të çelikut 'European', duke inaguruar kështu tregun e përbashkët për çelikun në prill 1953.

3. Romë, 25 mars 1957. Përfaqësuesit e gjashtë vendeve themeluese, Belgjikës, Republikës Federale Gjermane, Francës, Italisë, Luksemburgut dhe Holandës, nënshkruajnë Traktatet e Romës që themelojnë Komunitetin Ekonomik European (EEC) dhe Komunitetin European të Energjisë Atomike (Euroatom).

4. Më 7 shkurt 1992, kryetarët e shteteve dhe qeverive nënshkruajnë Traktatin e Maastrichtit për krijimin e bashkimit ekonomik dhe monetar.


5. Traktati i Amsterdimit i vitit 1997 i vuri vulën krijimit hap pas hapi të një zone të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë. Këtu është dokumenti i traktatit me firmat dhe vulat zyrtare.

6. Me një imazh të madh të projektuar mbi godinën e Komisionit European në Bruksel, BE-ja pret anëtarët e saj të rinj Bullgarinë dhe Rumaninë në vitin 2007.


7. Më 10 dhjetor 2012, Bashkimi European iu dha në Oslo Çmimi Nobel për Paqen. Komiteti i Çmimit Nobel nderoi kontributin e BE-së gjatë 6 dekadave, për mbrojtjen e paqes, demokracisë dhe të drejtave të njeriut në Europë.




©EU



©EU



©EU



© imagejlobe



# Si funksionon Bashkimi European?



Tre presidentët e tanishëm të BE-së. Secili nga institucionet kryesore të BE-së kryesohet nga një president. Nga e majta në të djathtë: Herman Van Rompuy (Këshilli European), José Manuel Barroso (Komisioni European) dhe Martin Schulz (Parlamenti European)



Shpesh herë BE-në e krahasojnë me një shtet. Thonë se “në BE gjërat funksionojnë në këtë apo atë mënyrë, por këtu është ndryshe, gjërat funksionojnë kështu”. Krahasime të tilla janë të natyrshme, por duhet të përdoren me kujdes. BE-ja nuk është një shtet, por një grupim i veçantë shtetesh dhe e ndryshme në strukturë nga ajo e vendit tuaj.

Qëllimi i këtij kapitulli është të shpjegojë strukturën e BE-së. Çfarë institucionesh ka ajo dhe çfarë bëjnë ato? Çfarë përgjegjësish kanë ato?

Nga e majta në të djathtë: Komisioni European në Bruksel, Parlamenti European në Strasburg, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit European në Luksemburg dhe Këshilli i Bashkimit European në Bruksel.



## Kush e ka pushtetin në Europë? Institucionet e Bashkimit European

► Kush e ka pushtetin aktualisht në Europë? Është e qartë që nuk ka një shef që jep urdhëra. Por dikush duhet të thotë se çfarë ndodh. Atëherë kush vendos për çështjet e Europës? Një komitet, një vend apo dikush tjetër?

Në pamje të parë duket gjithmonë e bezdisshme të merresh me institucionet, por pikërisht institucionet janë vendi ku ushtrohet pushteti. Prandaj struktura institucionale e Bashkimit European i përgjigjet gjithashtu çështjes së pushtetit. Por është e qartë se përgjigjja në BE është e ndryshme nga ajo në një shtet anëtar.

Bashkimi European është një grupim

i vendeve dhe qytetarëve të këtyre vendeve. Kjo pasqyrohet në strukturën e BE-së. Si shtetet (qeveritë), edhe popujt e këtyre vendeve kanë të drejtën të thonë fjalën e tyre për çështjet europiane. Kjo realizohet nëpërmjet Këshillit të Bashkimit European dhe Parlamentit European.

### **Këshilli i Bashkimit European**

(shpesh quhet Këshilli i Ministrave) është organi që përfaqëson qeveritë e vendeve të BE-së. Këtu ministrat e të gjithë shteteve anëtarë ulen së bashku. Në varësi të çështjes, këta mund të jenë ministrat e jashtëm, të brendshëm apo të bujqësisë. Këshilli është njëri prej dy organeve vendim marrëse. Ai diskuton çështje politike dhe miraton ligjet europiane të

quajtura rregulla dhe direktiva.

Kështu që pa Këshillin asgjë nuk leviz në Bashkimin European. Këshilli merr vendimet e tij ose unanimisht ose me shumicë votash. Për vendimet me shumicë duhet 70% e votave (kjo quhet shumicë e cilësuar). Vendet e mëdha të BE-së kanë më shumë vota nga vendet e tjera. Nga viti 2014 do të zbatohet parimi i ‘shumicës së dyfishtë’ që do të thotë se marrja e vendimit kërkon shumicën midis shteteve anëtare, duke përfaqësuar edhe shumicën e popullsisë. Presidenca e Këshillit ndryshon çdo 6 muaj dhe të gjithë shtetet anëtarë zgjidhen me radhë në kushte të barabarta. Më 2013, Irlanda dhe Lituania kishin presiden- ►



Janette: 'Parlamenti Europian përfaqëson qytetarët dhe votat për "ligjet Europiane" (direktivat dhe rregullat).'



Alice: 'Gjykata Europiane e Revizorëve monitoron buxhetin e BE-së.'



Patricia: 'Këshilli i Ministrave përfaqëson qeveritë e shteteve anëtarë të BE-së dhe miraton "ligjet europiane".'

► cën. Në 2014-n Presidenca do të mbahet nga Greqia dhe Italia, si edhe Letonia dhe Luksemburgu në 2015.

Vendimet kryesore për politikën europiane i merr Këshilli Europian. Ai përbëhet nga kryetarët e shteteve ose qeverive të BE-së, të cilët takohen rregullisht të paktën çdo 3 muaj. Ai kryesohet nga një president i zgjedhur për 2 vjet e gjysmë nga Këshilli Europian. Që nga viti 2009, ky post mbahet nga ish kryeministri belg Herman Van Rompuy.

Megjithatë, në të shumtën e rasteve Këshilli nuk mund të vendosë vetë. Ai ka nevojë për **Parlamentin Europian**, i cili përfaqëson qytetarët e vendeve të BE-së dhe është i zgjedhur drejtpërdrejt prej tyre. Deri në fund të periudhës së tanishme legjislativë Parlamenti ka 766 anëtarë nga të gjithë shtetet anëtarë. Me rizgjedhjen e Parlamentit Europian më 2014, sipas Traktatit të Lisbonës, do të ketë 751 vende.

Shtetet e mëdha Europiane kanë më shumë anëtarë se vendet e vogla. Parlamenti vetë nuk mund të marrë vendime me fuqi ligjore për BE-në; zakonisht ai duhet të miratojë një rezolutë të Këshillit të Bashkimit Europian që të hyjë në fuqi. Kjo quhet gjithashtu 'procedurë vendimi e përbashkët'. Parlamenti duhet të votojë për të mbështetur Komisionin Europian ose për ta rrëzuar atë. Ai miraton edhe buxhetin e Bashkimit Europian. Kështu që pa Parlamentin Europian, e përmes tij, pa përfaqësimin e drejtpërdrejtë të qytetarëve në Europë nuk mund të merren shumë vendime.

Një institucion tjetër i rëndësishëm është **Komisioni Europian**. Grupi i Komisionerëve përfshin një anëtar për çdo vend, por ata nuk përfaqësojnë pikëpamjet e vendeve nga vijnë, por interesat e përbashkëta të BE-së. Çdo anëtar i Komisionit përgjigjet për një fushë të caktuar. Komisioni bën të mundur që rregullat e përgjithshme të

zbatohen nga shtetet anëtare. Prandaj ai përshkruhet si "roje e traktateve europiane". Komisioni administron BE-në sipas udhëzimeve të Këshillit dhe Parlamentit. Një karakteristikë e veçantë e sistemit europian është fakti që Këshilli dhe Parlamenti mund të marrin vendime vetëm me propozimin e Komisionit. Kjo e drejtë e veçantë e Komisionit Europian i jep atij influencë në marrjen e vendimeve, sepse përcakton parametrat. Kjo bën që të merren në konsideratë interesat e përbashkëta të Bashkimit Europian që në fillim. Natyrisht Këshilli dhe Parlamenti mund të ndryshojnë propozimin.

Tani ka shumë ligje të përbashkëta që vendet e BE-së i kanë përpiluar së bashku. Sigurisht ka gjithashtu disa mosmarrëveshje lidhur me interpretimin e këtyre ligjeve. Përveç kësaj, vende të veçanta shpesh nuk pajtohen me dispozita të veçanta.

Prandaj të interesuarit mund të ape- ►



Jello: 'Banka Qëndrore Europiane bën të mundur që euro-ja të jetë e qëndrueshme.'



Motian: 'Komisioni Europian administron Bashkimin Europian dhe bën "ligjet Europiane".'

► lojnë në **Gjykatën e Drejtësisë të Bashkimit European**. Çdo shtet anëtar ka nga një gjykatës, i cili bën gjykime të pavarura në bazë të ligjit europian. Gjykata mund të shfuqzojë ligje që bien ndesh me ligjin europian dhe të gjobisë shtetet anëtare, në rast se nuk pajtohen me ligjin. Gjithkush e di se paraja është e rëndësishme. Por nuk mjafton ta kesh atë. Duhet të dish të ruash vlerën e saj.

Për këtë kujdeset **Banka Qëndrore Europiane (ECB)**, e cila është banka që emeton për vendet që përdorin euro-n në përdorim. Ajo përbëhet nga përfaqësues të vendeve që kanë futur euron. ECB administron monedhën dhe normat e interesit.

Buxheti i Bashkimit European më 2013 arriti rreth 133 miliard euro. Kur harxhohen shumë para, është e

rëndësishme po ashtu të merren masat që shpenzimet të bëhen sipas rregullave. Kjo është detyra e **Gjykatës Europiane të Revizorëve**, e cila kontrollon që paratë europiane shpenzohen si duhet dhe me arsye. Në këtë mënyrë ajo siguron një administrim financiar të efektshëm. Çdo shtet anëtar cakton një përfaqësues në këtë gjykatë.

## Ushtrim


### Cilat janë detyrat e institucioneve të BE-së?

Morët shumë informacion të përgjithëm, por ju duhet të dini se si funksionon BE-ja. Bëni detyrën e mëposhtme për të parë nëse keni qenë të vëmendshëm. Vini një kryq aty ku duhet sipas institucionit.

Përshkrimi	Këshilli i Europës	Këshilli i Bashkimit European	Parlamenti European	Komisioni European	Gjykata Europiane e Drejtësisë	Banka Qëndrore Europiane	Gjykata Europiane e Revizorëve
Bën propozime për rregullat e BE-së	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Përbëhet nga një përfaqësues për çdo shtet anëtar	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Përcakton normat e interesit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Monitoron shpenzimet e BE-së	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Zgjidhet nga populli	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Miraton ligjet e BE-së (rregullat dhe direktivat)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Emëron Presidentin e Komisionit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Administron BE-në	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Përfaqëson interesat e qytetarëve	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Përfaqëson interesat e Shteteve Anëtarë / qeverive të tyre	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Vendos për interpretimin e ligjeve Europiane	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Përcakton politikën	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

## Organet e Bashkimit European

Vendosni përgjegjësitë e institucioneve të ndryshme në një skemë tjetër. Ne e kemi filluar, ju bëni vetëm përshtatjen e termave në kutitë djathtas.



## Traktatet Europiane

► Bashkimi European bazohet ligjërisht tek traktatet që shtetet anëtare kanë nënshkruar me njëra-tjetrën, të ratifikuara nga parlamentet kombëtarë ose me referendum. Traktatet përcaktojnë se si merren vendimet, se cili institucion ka kompetencat të caktuara dhe në cilat fusha vendet e BE-së veprojnë bashkërisht. Zhvillimi i vazhdueshëm i BE-së rregullohet me

traktate të tjera. Nga traktatete ne shohim se si ka ndryshuar Bashkimi European. Baza aktuale është Traktati i Lisbonës, që u nënshkrua në kryeqytetin portugez më 2007. Traktati i Lisbonës hyri në fuqi më 2009, kur u ratifikua nga të gjithë shtetet anëtarë.



## Diskutim

Tani të kthehemi te çështja që filluam:

Kush e ka pushtetin në Europë?  
Diskutojeni këtë midis jush.

## Influenca e qytetarëve

► Qytetarët e shteteve anëtarë të BE-së ndikojnë në politikën e BE-së në dy mënyra. Së pari, kur zgjedhin parlamentin e tyre kombëtar, nga i cili krijohet qeveria. Ajo përfaqësohet në Këshillin e Bashkimit Europian (kur takohen 'shefat' – kryetarët e shtetit ose qeverisë – 'Këshilli Europian'). Së dyti, qytetarët ndikojnë në politikën e Europës kur

zgjedhin Parlamentin Europian.

Por individualisht qytetarët mund të ngrenë zërin e tyre në rast se mendojnë se janë trajtuar pa të drejtë ose kur kërkojnë të rregullojnë një situatë të padrejtë. Në fakt ka një përfaqësues të qytetarëve Europianë, të njohur si Ombudsman. Çdo qytetar i BE-së mund të

ankohet pranë tij dhe këtë mund ta bëjë edhe me e-mail. Pë kë apo çfarë mund t'i ankohesh atij, kur mund të ndihmojë ai dhe kur jo? Këto gjëra ju mund t'i gjeni në faqen elektronike të Ombudsmanit:

<http://ombudsman.europa.eu/home/en/general.htm>

## Mjetet e tjera të influencës

► Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës në 2009 lindi mundësia e iniciativës së qytetarëve Europianë. Një milion njerëz ose vetëm 0.2% e popullsisë, të paktën e një pjese të shteteve të BE-së (shtatë vende), mund t'i kërkojnë Komisionit Europian të shikojë një çështje dhe të propozojë një ligj. Sigurisht me kushtin që çështja të jetë në kompetencën e BE-së.

Mund të përdoren edhe protestat kundër institucioneve të BE-së për të ushtruar presion. Fermerët, sindikatat ose organizatat e mbrojtjes së mjedisit mund të ngrenë shqetësimet e tyre nëpërmjet organizimit të protestave. Parlamenti Europian ka gjithashtu një Komitet të Peticioneve.



## Ushtrim

Mësoni më shumë mbi iniciativën e qytetarëve europianë.

Iniciativa e qytetarëve europianë ushtron influencë të drejtpërdrejtë në punët e Bashkimit Europian. Çfarë initiative do të donit të ndërmerrnit dhe si do ta bënit këtë? Ju mund të njiheni me procedurë dhe me iniciativat aktuale në faqen e internetit: <http://ec.europa.eu/citizens-initiative/public/welcome>

## Çfarë është peticioni?

Mësoni çfarë është peticioni dhe kush mund t'i drejtohet Parlamentit. Mund të gjeni më shumë informacion në adresën: <http://www.europarl.europa.eu/aboutparliament/en/00533cec74/Petitions.html>  
A ka edhe në parlamentin tuaj një komision peticioni? Jepini, pyesni për këtë.

## Përfaqësuesit tanë në Strasburg dhe Bruksel

Deputetët e Parlamentit European organizohen në grupe në bazë të të njëjtit orientim politik. Jo të gjitha grupet përfshijnë anëtarë nga secili vend. Mësoni cilat parti nga vendi juaj kanë qenë të suksesshme në zgjedhjet e fundit të Parlamentit European dhe që kanë deputetë. Mësoni në cilat grupe të Parlamentit bëjnë pjesë ata.

Cila parti përfaqësohet dhe në cilin grup të Parlamentit European? Për shembull, ju mund t'i gjeni këto fare lehtë në: <http://www.europarl.eu>

Grupimet në Parlamentin European	Sa anëtarë ka ky grup?	Ky grup përfshin anëtarë të këtyre partive të vendit tim
 EPP – Grupi i Partive Popullore Europiane (Kristian Demokrate)		
 S&D – Grupi i Aleancës Progresive të Socialistëve dhe Demokratëve në BE		
 ALDE – Grupi i Aleancës të Liberalëve dhe Demokratëve të Europës		
 GREENS/EFA – Grupi i të Blerëve / Aleanca e Lirë Europiane		
 ECR – Grupi European i Konservatorëve dhe Reformistëve		
 EFD – Grupi Europa e Lirisë dhe Demokracisë		
 GUE/NGL – Grupi Konfederal i të Majtës Europiane të Bashkuar / E Majta e Blerët Nordike		
<b>NI</b> Të paadruarve		

## Ushtrim

Gjeni kush është deputet në Parlamentin European nga krahina apo rajoni juaj.

Cilën parti përfaqësojnë ata?

## Europa — lojë e shkurtër

Kush është presidenti aktual i Parlamentit European?


Dhe kush janë këta zotërinjtë në fotografi?

Herman Van Rompuy (Belgjikë)

José Manuel Barroso (Portugali)

Martin Schulz (Gjermani)

Robert Schuman (Francë)



President i Parlamentit European

President i Këshillit European

Ministri i Jashtëm francez 1948–52 dhe një nga themeluesit e Komunitetit European të Qymyrit dhe Çelikut (ECSC)

President i Komisionit European

## Si funksionon BE-ja

► Është e qartë se Bashkimi European nuk është një shtet si Lituania ose Holanda, për shembull, por ai është më shumë se një aleancë e lirshme e vendeve europiane. Për të shprehur originalitetin e tij shpesh herë juristët e përshkruajnë organizatën e BE-së si një organizatë "sui generis". Në latinisht kjo do të thotë 'një lloj i vetëm'. Ndonëse shtetet anëtarë të Bashkimit European mbeten sovranë dhe të pavarur, në disa fusha ata i kombinojnë kompetencat e tyre për t'u forcuar në përballimin e sfidave që ndeshin. Për këtë qëllim BE-ja ka krijuar institucione të veçanta, të cilave

praktikisht u janë deleguar këto kompetenca. Kjo do të thotë që vendimet për disa çështje të interesit të përbashkët të merren në mënyrë demokratike në nivel european. Ja përse BE-ja nuk ka një sistem federal si SHBA, për shembull, por është më tepër se një bashkim i lirshëm, siç është OKB-ja.

Në BE vendimet merren kolektivisht nga qeveritë kombëtare, të cilat mblihen në Këshillin European dhe në Parlamentin European, të zgjedhur nga popujt. Ka disa përjashtime kur Këshilli vendos vetë. Kjo është e vërtetë sidomos

në politikën e jashtme. Komisioni European ndjek problemet e BE-së dhe merr masat që të gjithë t'u përmbahen traktateve Europiane. Vendet që nuk e bëjnë këtë sillen përpara Gjykatës së Drejtësisë dhe mund t'u kërkohej të ndryshojnë rrugën. Gjykata Europiane e Revizorëve i mban sytë hapur për administrimin e duhur financiar të institucioneve Europiane. Secili nga ne mund të ankohet te Ombudsmani European nëse mendon se jemi trajtuar keq nga institucionet Europiane.

# 4 Çfarë bën BE-ja saktësisht?





Ka njerëz që thonë se Bashkimi Europian nuk bën sa duhet. Të tjerë thonë se ai ndërhyt në çdo gjë. A nuk e kanë të dyja palët gabim? Por si është e vërteta? Çfarë bën BE-ja saktësisht? BE-ja është aktive në shumë fusha të politikës, në politikën ekonomike, mbrojtjen e konsumatorit, politikën e jashtme, mbrojtjen e mjedisit, politikën e brendshme dhe drejtësinë, për të përmendur këtu vetëm disa.

Tani le të shohim disa shembuj të çështjeve politike në këto fusha. Kjo do t'ju japë juve një ide se çfarë bëjnë njerëzit në Bruksel dhe në kryeqytetet e vendeve të BE-së.

## Tregu i vetëm

► Guri i themelit i politikës ekonomike dhe sociale është tregu i vetëm. Ai është një fushë e përbashkët ekonomike që jep katër liri themelore, që janë:

- lëvizja e lirë e njerëzve
- lëvizja e lirë e mallrave
- lëvizja e lirë e shërbimeve
- lëvizja e lirë e kapitalit

## Liritë në tregun e vetëm European

► Lëvizja e lirë e njerëzve na prek në shumë drejtime. Nëse duam të shkojmë me pushime në një vend tjetër të BE-së, për të punuar apo për t'u vendosur atje, me apo pa një vend pune, këtë të drejtë e kemi. Dhe kur kthehemi nga jashtë ne me qejf sjellim blerjet tona, njëllon sikur bëjmë blerje në një vend tjetër me internet. Kjo gjë garanton lëvizjen e lirë të mallrave. Por jo vetëm mallrat, por edhe shërbimet mund të jepen e të merren përmes kufijve, në sajë të lëvizjes së lirë të shërbimeve. Njerëzit që duan të investojnë paratë e tyre në një vend tjetër të BE-së, në vend që ta bëjnë këtë në vendin e tyre, e kanë këtë mundësi, të garantuar nga lëvizja e lirë e kapitaleve.



## Eliminimi i kontrolleve kufitare

► Nëse udhëtoni nga Kepi Verior i Norvegjisë për në Siçili mund ta lini fare mirë pasaportën në shtëpi. Nuk ka më kontrolle në kufi brenda BE-së në të ashtuquajturat kufij ndërkombëtarë. (për shembull midis Finlandës dhe Estonisë ose Slovakisë dhe Republikës Çeke).

Kjo liri për të udhëtuar rregullohet me Marrëveshjen Shengen, e cila tani është pjesë e traktateve europiane. Mbretëria e Bashkuar dhe Irlanda nuk bëjnë pjesë në hapësirën Shengen, por bëjnë pjesë Lihtenshteini, Norvegjia dhe Zvicra. Për Bullgarinë, Kroacinë, Qipron dhe Rumaninë do të ketë periudha tranzitore para se të bëhen palë.

Marrëveshja Shengen ka marrë këtë emër nga një vend në Luksemburg ku është nënshkruar.



Europa — lojë e shkurtër

## Ç'kuptim kanë për ju katër liritë?

Përshtatni shembujt me katër aspekte të tregut të vetëm dhe gjeni kutinë e duhur.

	Lëvizja e lirë e njerëzve	Lëvizja e lirë e mallrave	Lëvizja e lirë e shërbimeve	Lëvizja e lirë e kapitaleve
Unë mund të blej një makinë në Danimarkë dhe ta nxjerr atë pa taksë.	1	0	2	3
Unë mund të udhëtoj ku të dua brenda BE-së.	9	6	3	7
Unë mund të depozitoj paratë e mia në një bankë gjermane.	2	3	1	0
Unë mund të studioj në Hungari.	5	1	0	9
Prindërit e mi rikonstruktuan banjën me një mjeshër portugez.	4	3	1	7
Prindërit e mi mund të më dërgojnë para në qytetin ku studioj në Spanjë.	1	2	3	9
Unë mund të porosit mallra nga Suedia me internet.	4	5	1	2
Unë mund punoj si arkitekt në Maltë dhe të ndërtoj shtëpi në Itali.	5	6	0	8

Përgjigjet japin një datë në formatin dita/muaji/viti. Gjeni ç'është kjo dhe çfarë ndodhi atë ditë.

.../.../....

# Monedha europiane

► Që nga viti 1999 ka një monedhë të përbashkët europiane, e cila që nga 1 janari 2011 përdoret në 18 vende të BE-së. Letonia filloi të përdorë si monedhë euron që nga 1 janari 2014, duke u bërë vendi i 18-të. Më shumë se 332 milion qytetarë të BE-së, dy të tretat e popullsisë së përgjithshme, përdorin euron si monedhë të përbashkët.

Në tregun e vetëm njerëzit mund të lëvizin lirisht dhe mallrat, shërbimet dhe kapitalet mund të tregtohen kudo. Duke mos patur pengesa monetare mund të sigurohen epërsi dhe përfitime më të mëdha në tregun ndërkombëtar për kompanitë dhe konsumatorët, punonjësit dhe të vetëpunësuarit. Është e lehtë të bësh pazar dhe të krahasosh çmimet në të gjithë kufijtë e BE-së kur i bën llogaritë në të njëjtën monedhë. Veçanërisht, me rritjen e blerjeve në internet njerëzit që nuk janë pranë një zone kufitare e kanë më lehtë. Transparenca më e madhe në ofertat ka një efekt kufizues në çmimet, që është gjë e mirë për cilindo që bën pazar.

Një epërsi tjetër e monedhës së përbashkët është fakti që nuk është nevoja të shkëmbeni para kur udhëtoni në vende të tjera. Kështu kursehen para dhe kohë. Por edhe kompanitë përfitojnë nga një monedhë e përbashkët, duke bërë llogari dhe duke dhënë fatura vetëm një herë, duke mos u rrezikuar nga luhajtjet e kursit të shkëmbimit. Eliminimi i këtyre "kostove të transaksionit" kufizon efektin edhe tek çmimet. Monedha e përbashkët ka çuar në uljen e normës së interesit duke u sjellë përfitim si konsumatorëve, ashtu edhe kompanive. Ka më shumë hapësirë për investime, gjë që çon në rritje. Një monedhë e qëndrueshme në BE, e bazuar në ekonomi të shëndosha të zones së euros, përforcon pozitën ekonomike të Europës në botë.


Ndërsa e gjithë BE-ja përfshihet në një treg të vetëm, një pjesë e saj (pa dyshim e madhe) përdor euron si monedhë të përbashkët. Disa vende nuk duan të hyjnë në zonën e euros tani për tani, vende të tjera nuk plotësojnë kriterin. P.sh. një

vend nuk duhet të ketë borxhe të mëdha nëse dëshiron të hyjë në zonën e euros. Inflacioni nuk duhet të jetë më shumë se 1.5 % më i lartë se normat më të ulta të zhvlerësimit në vendet e euros.

Pavarësisht këtyre rregullave të qarta, zona e euros ra në krizë më 2010. Kjo çështje është tepër e ndërlikuar, por në përgjithësi duhet thënë se pjesa më e madhe e problemeve ka ardhur nga fakti që vendet e euros nuk u janë përbajtur standardeve për të cilat kanë rënë dakord dhe kanë shtuar borxhet. BE-ja ka punuar dhe punon shumë për të shmangur rreziqet për monedhën e përbashkët. Këtu përfshihen garancitë për vendet në vështirësi për rifinancimin e borxheve të tyre në tregjet ndërkombëtare të kapitaleve, në përqindje të pranueshme interesi. Për këtë arsye vendet e euros kanë krijuar një paketë shpëtimi prej 700 miliard eurosh (ESM ose Mekanizmi European i Stabilitetit) për të ruajtur stabilitetin.

Në të njëjtën kohë vendet e euros kanë ndërmarrë një pakt fiskal për të ulur nivelin e borxheve. Ketë marrëveshje ndërkombëtare e kanë nënshkruar edhe vendet që nuk janë në grupin e euros, me përjashtim të Republikës Çeke dhe Mbretërisë së Bashkuar. Përveç pakësimit të borxhit, kjo synon gjithashtu forcimin e konkurrencës të vendeve të euros dhe BE-së në tërësi.

Një pjesë e problemit me monedhën e përbashkët lidhet me faktin se bankat nuk i janë nënshtruar një kontrolli të mjaftueshëm. Për këtë arsye BE-ja ka forcuar sistemin bankar, për të mos lejuar që bankat të fusin në vështirësi të gjitha vendet në mënyrë spekulative. Këto vitet e fundit kanë qenë të vështira për monedhën e përbashkët dhe janë dashur shumë energji për të përballuar krizën. Por kjo tregoi gjithashtu vendosmërinë e vendeve të euros për të mbajtur të qëndrueshme monedhën e përbashkët. ►



- Shtetet e BE-së që përdorin euron nga viti 2013
- Shtetet e BE-së që nuk përdorin euron

Letonia pritet të përdorë euron si monedhë të saj nga 1 janari 2014.

## ► Politika ekonomike Europiane

Për të forcuar dhe stimuluar ekonominë e Bashkimit European, Komisioni ka ndër-tuar strategjinë 'Europa 2020' për rritjen dhe punësimin. Ndër të tjera ajo para-shikon investime në arsim dhe punë kër-kimore, që Europa të bëhet një nga rajo-net më novatore në botë në të ardhmen. Qëllimi është që të forcohet biznesi dhe industria, të cilat jo vetëm duhet të jenë konkurrese, por të paktën të kenë një ndikim të mundshëm në mjedis. Qëllime të tjera janë krijimi i vendeve të punës

dhe lufta kundër varfërisë brenda BE-së. Meqenëse vetë Bashkimi European e sheh veten si një komunitet vlerash të lidhur me parimet e barazisë dhe solida-ritetit, është e rëndësishme që nga kjo rritje të përfitojnë të gjithë Europeanët.

### Marrja e vendimeve në BE

Normalisht vendimet në BE merren nga të gjitha shtetet anëtare së bashku. Por ka disa çështje që veçanërisht prekin vendet që e kanë euron monedhën e tyre të përbashkët. Ministrat e tyre takohen

rregullisht në grupin e euros dhe vendosin se ç'duhet të bëhet në zonën e monedhës së përbashkët. Sigurisht këto vendime prekin edhe vendet e tjera të Bashkimit European, që nuk e kanë (ende) euron monedhën e tyre, por preken nga ajo në tregun e vetëm.



## Ushtrim

# Kush duhet të vendosë për monedhën e përbashkët?

Ka mendime të ndryshme lidhur me vendimet që merren nga grupi i euros brenda Bashkimit European, si për shembull:

- 'Është plotësisht e drejtë që vendet e euros të vendosin çdo gjë midis tyre, të ruajnë sigurinë dhe stabilitetin e monedhës së përbashkët. Kjo është rruga si punohet dhe kështu duhet të mbetet'.
- 'Vendet e euros duhet të vendosin jo vetëm për çështje imediate monetare, por edhe për çështje të të ardhmes ekonomike të zonës së euros në tërësi. Ato përbëjnë grupin kryesor brenda BE-së dhe duhet të vendosin vetë për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ekonominë e euros së përbashkët. Kjo ka të bëjë me çështje si taksat, punësimi dhe siguria sociale. Kjo është veçse e drejtë, edhe sikur vendimet të prekin vendet e tjera të Bashkimit European. Nëse ato duan të thonë fjalën e tyre për këto gjëra, ato mund t'i bashkohen euros kurdoherë.
- Nuk mund të jetë e drejtë që vetëm 18 vende të vendosin për të gjitha vendet e zonës së euros. BE-ja vendos për shumë gjëra të tjera që nuk u përkasin të gjithëve, çështje që kanë të bëjnë me Balltikun apo Mesdheun, për shembull. Por ato ende votojnë për këto gjëra. Shumica e vendeve të Europës synojnë gjithashtu që pas disa vitesh t'i bashkohen grupit të monedhës. Prandaj ato duhet të japin mendimin e tyre tani për zhvillimin e mëtejshëm.

Çfarë mendoni ju? Diskutoni pikëpamjet e ndryshme në grupe dhe jepni mendimin tuaj, që mund ta diskutoni pastaj me grupet e tjera. Ju mund të gjeni informacion tjetër mbi mënyrën si funksionon zona e euro-s në faqen e internetit: <http://eurozone.europa.eu/>.



Europa — lojë e shkurtër

★ Cilat janë tre vendet që nuk bëjnë pjesë në zonën e euro-s? Shënojin.

Austri	Francë	Luksemburg	Sllovaki
Belgjikë	Gjermani	Maltë	Slloveni
Qipro	Greqi	Holandë	Spanjë
Estoni	Irlandë	Poloni	Suedi
Finlandë	Itali	Portugali	Mbretëri e Bashkuar





## Masat për mbrojtjen e klimës

► Klima globale ndryshon dhe atmosfera e tokës po ngrohet. Kjo ka pasojë të padëshirueshme për motin: ka më shumë furtuna dhe përmbytje, verë më të nxehtë, shtim të shkretëtirave në Afrikë dhe Europën jugore, shkrije të akujve polarë, ishuj të tërë që fundosen. Ne nuk mund të jemi indiferentë për gjitha këto. Ndryshimi i klimës ka shumë të bëjë me çlirim të gazrave të dëmshëm nga vendet e industrializuara. Fatkeqësisht procesi nuk mund të kthehet, prandaj është e rëndësishme të kufizohet rritja e temperaturës. Në vitet e ardhshme do të vendoset nëse mund ta bëjmë këtë. Prandaj një veprim i shpejtë dhe i qëndrueshëm është veçanërisht i rëndësishëm. Asnjë vend nuk mund ta ndalojë klimën së

ndryshuari. Në 2008, BE-ja përcaktoi qëllime të qarta:

- pakësim prej 20% të gazrave të dioksidit të karbonit
- rritje në përqindjen e energjive të rinovueshme (era, energjia djellore, etj) deri në 20%
- kursim prej 20% të energjisë.

Kjo e vendos Europën në pararojë dhe ajo mund të përpiqet të bindë ndotësit dhe konsumatorët kryesorë të energjisë si SHBA dhe Kinën të marrin pjesën e tyre të përgjegjësisë.



## Ushtrim

### A mendoni se kjo politikë është e drejtë?

Me cilat nga opinionet e mëposhtme pajtoheni ju?



	Plotësisht dakord	Pjesërisht dakord	Paksa kundër	Plotësisht kundër
BE-ja të ulë çlirimin e gazrave të dëmshme vetëm në rast se edhe të tjerët e bëjnë këtë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
BE-ja duhet të realizojë objektivat e saj.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
BE-ja duhet t'i verë vetes detyra edhe më ambicioze.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Ne nuk duhet të lejojmë që diskutimet të na çmendin. Nuk është tragjedi po të rritet temperatura 2 gradë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Sidoqoftë vendet e BE-së nuk do t'i arrijnë objektivat e tyre, sepse në të vërtetë ato nuk janë të interesuara për të arritur objektiva të përbashkëta. Ato janë të interesuara vetëm për çfarë ndodh në vendin e tyre.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Mbrojtja e klimës nuk duhet të arrihet në dëm të vendeve të punës.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Ne nuk duhet të kemi objektiva të diktuar nga shkencëtarët, por duhet të jemi në gjendje të sigurojmë, aq sa të mundim, mbrojtjen e klimës, pa na dëmtuar ne.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Mbrojtja e klimës krijon vende të reja pune. Kompanitë dhe punonjësit përfitojnë nga kjo. Kjo është një arsye tjetër për të ndërhyrë në këtë fushë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

# Zona e përbashkët e drejtësisë

► Europa prej shumë kohësh u bë një territor i vetëm. Shumë njerëz kalojnë kufijtë ndërkombëtarë të vendeve të BE-së për të jetuar dhe punuar diku gjetkë, ose thjesht për të parë. Ata njihen me njëri-tjetrin, qëndrojnë aty dhe marthohen. Nganjëherë gjërat nuk shkojnë mirë dhe ata ndahen. Atëherë ka rëndësi të ketë një grup uniform ligjesh, sepse bëhet fjalë për çështje të jetesës dhe të kujdestarisë. Në rast se një burrë nga Austria dhe një grua nga Luksemburgu jetojnë në Itali dhe ndahen atje, ata nuk mund t'i drejtohen legjislacionit të tyre kombëtar. Për këtë arsye është shumë i rëndësishëm

bashkëpunimi midis vendeve të BE-së në fushën e të drejtës civile. Kjo ka të bëjë edhe me raste të trashëgimisë dhe shumë çështje të tjera që prekin jetën tonë të përditshme.

Kriminelët gjithashtu duan kufij të hapur, sepse mendojnë se kështu mund t'i shmangen ndjekjes penale. Por e kanë gabim, sepse tani ka një bashkëpunim të ngushtë midis policisë dhe autoriteteve të zbatimit të ligjit. Këtë ndërveprim e koordinon Zyra e Policisë Europiane, Europol.

## Të drejtat themelore Europiane

Të drejtat themelore të njeriut kanë rën-

dësi shumë të madhe në të gjitha shoqëritë, sepse ato prekin çdo njeri. Në BE, një grup demokracish, të drejtat themelore mbrohen në nivel kombëtar, përgjithësisht nga kushtetuta. Por meqenëse vetë Bashkimi Europian miraton ligje dhe rregullore që prekin njerëzit, është e rëndësishme të theksohet se ekziston edhe Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian, e cila është pjesë e Traktatit të Lisbonës. Ju mund ta gjeni tekstin e saj në:

[http://europa.eu/legislation\\_summaries/human\\_rights/fundamental\\_rights\\_within\\_european\\_union/l33501\\_en.htm](http://europa.eu/legislation_summaries/human_rights/fundamental_rights_within_european_union/l33501_en.htm)

<http://integrimi.gov.al>

## Ushtrim

Shikoni Kartën Europiane të të Drejtave Themelore dhe krahasojeni atë me kushtetutën tuaj kombëtare ose ligjin themelor.

Cilat rregulla janë të ngjashme? Çfarë gjendet vetëm në Kartën e të Drejtave Themelore? Çfarë mungon në Kartën e të Drejtave Themelore? Bëni një listë për rishikim.

## Diskutim

Diskutim mbi Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian.

Sa e rëndësishme është Karta Europiane e të Drejtave të Njeriut? A e kemi vërtet të nevojshme atë kur kemi të drejtat kushtetuese kombëtare? Sikur ju të përpilonit Kartën e të Drejtave Themelore ç'ndryshim do të kishte kjo? Çfarë do të shtonit ju? Çfarë do të hiqnit?


Diskutoni këto pyetje në grupe të vogla dhe krahasoni rezultatet.



## Pema e politikës Europiane.

Shumë gjethe varen në pemën e politikës Europiane. Këtu ka disa fusha të politikës në të cilat shtetet anëtarë bashkëpunojnë brenda BE-së.

Vendosni gjethet në fusha të ndryshme të politikës në mënyrë që ato të varen në degën e duhur.



Liria për të udhëtuar (Shengen)	Standardet mjedisore të përbashkëta	Monedha e përbashkët	Energjitë e rinovueshme	Pol. e jashtme e përbashkët	Pol. e përbashkët e sigurisë dhe mbrojtjes	Pol. e përbashkët e azilit
Zhvillimi rural	Tregu i vetëm	Mbrojtja mjedisore	Etiketimi ushqimeve	Standardet e detyrueshme të ushqimeve	Tarifat e ulura celulare roaming	
Zbatimi i të drejtës zakonore	Politika strukturore në mbështjetje të rajoneve	Standardet sociale të detyrueshme	Bashkëpunimi në seancat civile dhe penale			

# Europa shkon përpara — zgjerimi i Bashkimit European



Festimi i zgjerimit të BE-së në Portën Brandenburg në Berlin. Qindra balona blu 'Europa' u lëshuan më 1 maj 2004 në kryeqytetin gjerman për të festuar mirëseardhjen e Qipros, Republikës Çeke, Estonisë, Hungarisë, Letonisë, Lituanisë, Maltës, Polonisë, Sllovakisë dhe Sllovenisë.

Bashkimi European u krijua nga gjashtë vende, por synimi ka qenë gjithmonë për të përfshirë gjithë Europën, pra BE-ja ka qenë e hapur për të përfshirë anëtarë të tjerë.

Tani BE-ja ka 28 anëtarë dhe të tjerë presin prapa derës. Çfarë ka që BE-ja që është tërheqëse për këto vende të tjera? Cili është hapi tjetër në procesin e zgjerimit? Ne do të diskutojmë për këto çështje në këtë kapitull.

## Parimet e BE-së

- Po t'u kthehemi Traktateve të Romës të nënshkruara më 1957, të cilat krijuan Komunitetin Ekonomik European të Energjisë Atomike, preambula thotë:

'TË VENDOSUR me këtë veprim për të bashkuar burimet e tyre për ruajtjen dhe forcimin e paqes dhe lirisë dhe duke u bërë thirrje popujve të tjerë të Europës, të cilët ndajnë idealin e tyre të bashkojnë përpjekjet e tyre'

Sot, neni 49 i Traktatit mbi Bashkimin European thotë:

'Çdo vend evropian që respekton vlerat e përmendura në nenin 2 dhe është i angazhuar t'i përkrahë ato, mund të kërkojë të bëhet anëtar i Bashkimit European.'

Neni 2 i Traktatit mbi Europën thotë:

'Bashkimi' është krijuar mbi bazën e vlerave të respektit për dinjitetin e njeriut, lirinë, demokracinë, barazinë, sundimin e ligjit dhe respektin e të drejtave të njeriut, përfshi të drejtat e personave që u përkasin minoriteteve. Këto vlera të përbashkëta për shtetet anëtarë në një shoqëri ku pluralizmi, mosdiskriminimi, toleranca, drejtësia, solidariteti dhe barazia midis grave dhe burrave kanë epërsi.'



Traktati i Romës me firmat e kryetarëve të shteteve ose qeverive dhe të përfaqësuesve të gjashtë vendeve themeluese.

### Ushtrim

## Cili vend mund të bëhet anëtar?

Ç'kuptim kanë parimet e përfshira në nenin 2 në praktikë? Ç'duhet të bëjë një vend në rast se do të hyjë në BE dhe çfarë nuk duhet ta bëjë asnjëherë? Ç'mendoni ju?

Një vend ...	mund të hyjë në BE	nuk mund të hyjë
... që nuk ka liri të shtypit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
... që zbaton dënimin me vdekje	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
... që lejon qytetarët e saj të protestojnë kundër qeverisë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
... që ka parlament të zgjedhur rregullisht	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
... që ka një president që drejton deri sa vdes dhe pasardhës vjen djali i tij	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
... ku homoseksualët dhe lesbiket kanë të njëjtat të drejta si dhe heteroseksualët	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
... ku ushtria përcakton politikën dhe mund edhe të ndërhyjë në punët e brendshme me forcë ushtarake	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
... ku njerëzit konsiderohen të pafajshëm deri sa fajësia të përcaktohet me gjyq	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
... që ka vetëm një parti dhe prandaj ajo është gjithmonë në qeveri	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
... që mbron pakicat edhe kur shumica do të donte të ushtrohej më shumë presion mbi to	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

# Ku janë kufijtë e Europës?

► Çështjes së kufijve të Europës nuk mund t'i jepet përgjigje gjeografikisht. Në lindje dhe sidomos në juglindje Europa nuk ka kufij të qartë. Madje gjeografët kanë qenë dhe janë në mëdyshje se ku mbaron kontinenti. Në historinë e gjeografisë ka pasur shumë përcaktime të ndryshme, në varësi të studiuesve përkatës.

Kjo do të thotë se ne nuk shohim hartën apo globin që të zbulojmë aty Europën, por ne kemi një konceptim në kokën tonë, të cilin e rizbulojmë. Kjo është e qartë kur ka kufij të dallueshëm

natyralë të kontinentit, në veri dhe në perëndim. Në perceptimin tonë Islanda është pa dyshim pjesë e Europës. Në fakt, nga Europa kontinentale deri në Atlantikun Verior është një rrugë e gjatë.

Ne të gjithë e kemi të qartë se Mbretëria e Bashkuar (MB) dhe Irlanda janë pjesë e Europës. Por kanali midis Francës kontinentale dhe MB-së është më i gjerë se ngushtica e Gjibraltarit, që ndan Spanjën nga Maroku.

Ja se ç'thotë Komisioni European për këtë çështje:

'Termi "European" kombinon elementë gjeografikë, historikë dhe kulturorë, të cilët kontribuojnë në identitetin European. Përvoja e përbashkët e ideve, vlerave dhe ndërveprimit historik nuk mund të kthehet në një formulë të thjeshtë pa afat dhe është një çështje për t'u shqyrtuar nga të gjithë brezat e ardhshëm.'

*Burimi: 'Strategjia e zgjerimit dhe sfidat kryesore 2006-07', Komunikim nga Komisioni për Parlamentin European, Bruksel, 8 nëntor 2006, COM(2006) 649, f.19.*

## Ushtrim

### Ku mbaron Europa?

Një vend që dëshiron të hyjë në BE duhet të jetë një vend demokratik. Por njëkohësisht duhet të jetë edhe vend europian.

Ku janë kufijtë e Europës? Merrni një hartë fizike ose një atlas dhe përcaktoni kufijtë e Europës. Cilat janë kriteret për të vendosur nëse një vend është apo nuk është pjesë e Europës? Ku është Turqia? A është Irlanda pjesë e Europës? Cili është qëndrimi për Gjeorgjinë? Ose për Grenlandën? Po për Marokun?

Kur të keni përcaktuar kufijtë e Europës për vete, lexoni tekstin e mëposhtëm.



Gjeografia

Historia

Ndryshimet

Ngjashmëritë

Muzika

Kinemaja

Letërsia

Ushqimi

Pija

Liria

Pushimi

Ekonomia

Udhëtimi

Arsimi

Problemet

Pritshmëritë

## Ushtrim

### Një udhëtim në Australi

Imagjinoni sikur do të shkoni në Australi si pjesë e shkëmbimit shkollor. Australia është shumë larg dhe pa diskutim nuk është pjesë e Europës. Por shokët e klasës janë kuriozë dhe kërkojnë të bëni një paraqitje të shkurtër para klasës për këtë çështje. 'Ç'është Europa?'

Përgatisni një prezantim të përshtatshëm në një grup të vogël. Keni vetëm 5 minuta për të folur, prandaj përqëndrohuni në gjërat më të rëndësishme dhe aspektet më interesante. Si do t'u shpjegoni njerëzve të moshës tuaj në Australi se ç'është Europa?

Përpquni t'u jepni atyre një 'ide' për Europën. Cila është mënyra e veçantë e jetesës këtu, çfarë ju bën juve të ndjeheni europianë? Çfarë ju pëlqen në Europë dhe çfarë nuk shkon aq mirë?

Këtu ka disa fjalë kyçe. Mendoni cilat pika do të përfshini në bisedën tuaj dhe cilat jo dhe mos harroni që 5 minuta nuk janë shumë!

# Shtetet e Ballkanit Perëndimor

► Kroacia hyri në BE në korrik 2013. Shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor janë pranuar në parim si kandidatë të Bashkimit Europian. Këto janë Shqipëria, Bosnja Herzegovina, ish Republika jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Serbia.

Me përjashtim të Shqipërisë, të gjitha këto vende ishin pjesë e Jugosllavisë që u shkëputën prej saj në vitet 1990-të, shpesh herë pas luftërash të ashpra. Serbia dhe Mali i Zi mbetën së bashku deri në ndarjen paqësore më 2006. Më 1998/99 shpërtheu një konflikt i dhunshëm lidhur me statusin e Kosovës si pjesë e Serbisë, i cili së fundi u zgjidh me veprimin e NATOs kundër Serbisë. Pastaj Kosova u vu nën kujdestarinë e administratës së Kombeve të Bashkuara. Ajo shpalli pavarësinë më 2008.

BE-ja e konsideron anëtarësimin e këtyre vendeve në BE si shansin më të mirë për arritjen e një paqeje të qëndrueshme në rajon. Kjo u confirmua nga kryetarët e shteteve dhe qeverive në Konferencën e Selanikut në Greqi më 2003. Por Kosova nuk është njohur sipas të drejtës ndërkombëtare nga pesë vende të BE-së.

## Rruga e gjatë e pranimit në BE

Shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë për të bërë një rrugë të gjatë para se të hynë në BE.

Së pari ata duhet të nënshkruajnë një marrëveshje stabilizim-asociimi me

Bashkimin Europian, që i detyron ato të bëjnë reforma konkrete. Kjo marrëveshje duhet të ratifikohet pastaj nga të gjithë shtetet anëtare dhe sigurisht nga vetë shteti partner që do të thotë të votohet në parlament.

Pastaj marrëveshja duhet të zbatohet dhe pas kësaj, shtetet e interesuar kërkojnë anëtarësimin. Në rast se përveç Komisionit Europian mban një qëndrim pozitiv edhe Këshilli Europian (kryetarët e shteteve ose qeverive të BE-së) atëherë ata pranojnë si kandidatë.

Kur zbatohen reforma të mëtejshme mund të fillojnë negociatat. Në to bëhet fjalë se kur do të jenë në gjendje vendet kandidatë të pranojnë ligjet e përbashkëta të BE-së.

Nëse negociatat përfundojnë me sukses, gjë që mund të kërkojë disa vjet, traktati i pranimit duhet të ratifikohet nga vendet kandidatë dhe gjithë vendet anëtare të BE-së. Në disa vende kjo bëhet me referendum. Parlamenti Europian gjithashtu duhet të votojë në favor. Vetëm atëherë vendet kandidatë mund të bëhen anëtarë të BE-së.

## Në ç'fazë janë këto vende?

Vendet e Ballkanit Perëndimor janë në faza të ndryshme të rrugëtimit. Negociatat me **Kroacinë** kanë përfunduar dhe ajo u pranua në BE më 1 korrik 2013. **Mali i Zi** zhvillon negociatat për



pranim që nga viti 2012.

**Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë** zyrtarisht është kandidatë, por negociatat ende nuk kanë filluar. **Serbia** i ka filluar negociatat në 21 janar 2014. Vendet e tjera (Shqipëria, Bosnja - Herzegovina, dhe Kosova) konsiderohen ende 'kandidatë potencialë'. **Shqipëria** ka nënshkruar marrëveshjen e stabilizim asociimit që është në fuqi që nga viti 2009. Komisioni Europian më 2012 rekomandoi dhënien e statusit të kandidatit Shqipërisë. Marrëveshja e stabilizim asociimit është nënshkruar edhe me **Bosnje-Herzegovinën**, por ende nuk ka hyrë në fuqi. Zhvillimet demokratike në **Kosovë** mbështeten nga një mision i BE-së atje.



Ushtrim

## Cilat dhe ku janë?

Shënoni emrat e vendeve dhe kryeqytetet e tyre në hartë. Mund të përdorni hartën në fund të broshurës për t'ju ndihmuar.



## Ushtrim

# Hapat drejt anëtarësimit në BE

A i numëruat hapat që duhet të bëjnë vendet e Ballkanit Perëndimor para se të bëhen anëtarë të BE-së?

Vendosni hapat e mëposhtme në vendin e duhur në shkallët që çojnë vendet në BE.



## Ushtrim

# Në ç'fazë janë vendet e Ballkanit Perëndimor?

Vendosni numrin e duhur në kuti

	Shqipëria
	Bosnja dhe Herzegovina
	Kroacia
	Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë
	Kosova
	Mali i Zi
	Serbia

# Dy kandidatë të tjerë për anëtarësim në BE: Turqia dhe Islanda

- ▶ Turqia, sot një vend dinamik, është partner i BE-së në shumë fusha. Për shembull, BE-ja është partneri më i madh tregtar i Turqisë. Ky bashkëpunim i ngushtë me BE-në ka filluar rreth 50 vjet më parë. Ka një bashkim doganor me Turqinë që nga viti 1995. Procesi aktual i pranimit ka filluar më 1999 dhe është mbështetur unanimisht nga të gjitha shtetet anëtare. Sot opinionet, nëse procesi do të çojë në pranim apo jo, janë të ndara. Anëtarësimi në BE mbetet një qëllim strategjik i Turqisë.



Islanda, në veri, që nga viti 1993 ka qenë anëtare e Zonës Ekonomike Europiane, ku zbatohen shumica e rregullave të ekonomisë së vetme të BE-së. Vendi është një demokraci e qëndrueshme dhe tanimë ka lidhje të ngushta me BE-në. Ajo bën pjesë në zonën Shengen, që u jep qytetarëve të saj maksimumin e lirisë së lëvizjes sepse nuk ka më kontrolle kufitare. Islanda kërkoi të hyjë në Bashkimin Europian më 2009. Negociatat për pranimin vazhdojnë që nga korriku 2010.

## Po më tej?

- ▶ Është e qartë se debati mbi zgjerimin nuk është tjetër veçse i thjeshtë. Nga njëra anë, Bashkimi Europian nuk e ka parë asnjëherë veten si një klub përjashtues, por gjithmonë ka dashur të jetë i hapur ndaj të gjitha vendeve Europiane.

Në të kaluarën, shtimi i anëtarëve të rinj ka ndihmuar për ruajtjen dhe stabilitetin e paqes në Europë. Pas rënies së Perdes së Hekurt dhe shembjes të Bashkimit Sovjetik, politika e zgjerimit të BE-së shtriu zonën demokracisë dhe të

ekonomisë së tregut drejt vendeve të Europës qendrore dhe lindore. Nëntë vende që bënin pjesë në ish bllokun sovjetik tani janë anëtarë të BE-së, plus Sllovenia, dhe nga viti 2013 Kroacia, që bënin pjesë në ish-Jugosllavinë, (e cila gjithashtu u shpërbë), si dhe ishujt mesdhetarë të Maltës dhe Qipros.

Nga ana tjetër, është akoma e paqartë, (dhe nuk mund të jetë e qartë përfundimisht) ku mbaron kjo Europë dhe sa larg do të shkojë politika e

premtimit që u bëhet vendeve për anëtarësim dhe kur do të bëhet më në fund pranimi i tyre.

Kjo politikë do të vazhdojë të ndiqet me vendet e ish Jugosllavisë dhe Shqipërinë, që bën gjithashtu pjesë në rajonin që ne e quajmë 'Ballkani Perëndimor', si dhe me Islandën dhe Turqinë. Ato e kanë perspektivën e anëtarësimit, edhe nëse kjo do të dojë një kohë të gjatë para se disa vende të jenë në gjendje të realizojnë ëndrrën e tyre.

# Europa dhe bota në përgjithësi





Ne europianët nuk jemi të vetmit në botë. Ne as nuk përbëjmë shumicën e popullsisë së botës edhe për një kohë të gjatë. Prandaj ne nuk duhet të merremi vetëm me veten tonë, duhet t'u kushtojmë vëmendje edhe kontinenteve të tjerë, të cilët janë partnerë tanë, sepse ata blejnë prodhimet tona dhe ofrojnë mallrat e tyre, na furnizojnë me lëndët e para, të cilat ne nuk i kemi. Por ka edhe probleme që ne nuk mund t'i anashkalojmë. Këtu përfshihen luftrat dhe prapambetja në zhvillim, që u mohon shumë popujve një jetë të denjë. Edhe ndotja e mjedisit apo ndryshimi i klimës nuk ndalen në kufijtë e Bashkimit Europian.

## Ushtrim

### Kontinentet e botës

Po të lemë mënjanë Antarktidën ne mund ta ndajmë botën në gjashtë kontinente: Afrika, Azia, Australia/Oqeania, Europa, Amerika e Veriut dhe Amerika e Jugut. Ka ndarje të tjera, që grupojnë Amerikën e Veriut dhe të Jugut së bashku ose kombinojnë Europën dhe Azinë si Eurazia. Por ne do të mbetemi te gjashtë kontinentet (përfshijtur Antarktidën). Gjeni informacionin që mungon dhe shënojeni në tabelën më poshtë.

Kontinenti	Sipërfaqja	Përqindja e sip. së tokës	Popullsia	Renditja sipas popullsisë	PPB(*) për frymë në dollarë USA	Renditja sipas PPB(*)
Afrika						
Azia						
Australia/Oqeania						
Europa						
Amerika e Veriut						
Amerika e Jugut						

(\*) PPB: Prodhimi i Përgjithshëm Bruto.

## Interesat e Europës në botë

- ▶ Europa është relativisht një kontinent i vogël, por ekonomikisht i rëndësishëm.
  - Mbron interesat e BE-së dhe shmang terrorizmin, krimin e organizuar dhe imigracionin ilegal.
  - Ndhmon për të ruajtur mjedisin (politika për klimën, mbrojtja e mjedisit, etj.).
- Ndikon për sigurimin dhe të ruajtjen e paqes në botë (p.sh. në Lindjen e Mesme apo Afrikë).
- Ndhmon vendet e tjera të zhvillohen dhe të kapërcejnë varfërinë, analfabetizmin dhe prapambetjen.
- Mbron demokracinë dhe sundimin e ligjit në gjithë botën.



## Ushtrim

# Sfidat globale

Në fund të vitit 2003, Bashkimi Europian ra dakord për çështjet më të rëndësishme të strategjisë së sigurisë. Kjo përcaktoi edhe sfidat globale përpara BE-së. U hidhni një sy sfidave dhe përshtatni zgjidhjet e propozuara nga Strategjia Europiane e Sigurisë për fushat e problemeve të ndryshme.

Sfidat globale	Zgjidhjet e propozuara
Luftrat dhe konfliktet civile	
Varfëria	
Sëmundjet	
Prapambetja	
Mungesa e burimeve	
Varësia e Europës për energji	
Një popullsi e plakur në Europë	
Terrorizmi	
Përhapja e armëve të shkatërrimit në masë	
Krimi i organizuar	
Kërcënimi i mjedisit natyror	

Zgjidhjet e propozuara nga strategjia Europiane e sigurisë

Ndihma për zhvillim për Afrikën	Shlyerja e borxheve për vendet e pazhvilluara	Mbështetja e demokracisë në vendet e tjera	Ruajtja e burimeve ujore të botës
Vendosja e sistemit shëndetësor në vendet e pazhvilluara	Lufta kundë terrorizmit ndërkombëtar	Mbrojtja e klimës	Ruajta e paqes me ndërhyrje ushtarake
Kontrolli ndërkombëtar i armëve dhe marrëveshjet e çarmatimit	Dialogu me botën islamike	Bashkëpunimi për energjinë në kufijtë Europianë	Administrimi i imigracionit
Lufta kundër ndotjes së oqeanëve	Bashkëpunim ndërkombëtar i policisë	Hapja e tregjeve europiane për mallrat e vendeve në zhvillim	Siguria në internet

# Fortesa Europë?

► Një çështje e rëndësishme brenda Bashkimit European është migrimi. Migrimi në thelb do të thotë 'zhvendosje' dhe përshkruan situatën kur njerëzit lenë një vend për t'u vendosur diku gjetkë. Në fakt debati ynë zyrtar është për imigrimin ose migrimin në Europë. Ka **imigrim legal** në shtetet anëtare të Bashkimit European kur njerëzit shkojnë zyrtarisht, me leje për të punuar, për të studiuar ose thjesht për të jetuar (p.sh. si bashkëshort ose bashkëshorte e një qytetari të BE-së) nga vendet jo europiane në vendet anëtare të BE-së. Shumë nga këta njerëz vijnë me shpresën për një jetë më të mirë në Bashkimin European. Por ata janë të rëndësishëm, pasi shpeshherë imigrantët sjellin mjeshhtërinë dhe gatishmërinë e tyre për t'u integruar në ekonominë europiane. Ardhja e të rinjve është veçanërisht e rëndësishme, sepse shoqëria përgjithësisht po plakët, me të gjitha problemet e saj, si financimi i pensioneve apo sigurimet shoqërore.

Për ta bërë më të lehtë për njerëzit e kualifikuar nga jashtë BE-së për t'u rivendosur në BE, është futur një 'Blue Card'. Kështu ata mund të punojnë nga 1 deri në 4 vjet në BE. Deri tani shumica e imigrantëve të arsimuar nga vendet jo të BE-së kanë shkuar në SHBA.

Sikundër ekziston imigrimi legal dhe i dëshirueshëm, ekziston edhe **imigrimi ilegal**, kur njerëzit vijnë pa leje. Në këtë rast ata shkelin ligjin e vendeve të BE-së, por shpesh ata janë viktimë të bandave që u marrin edhe qindarkën e fundit për t'i trafikuar në Europë. Për shumë njerëz në botë, Europa duket si një parajsë ku duan të arratisen. Ne të gjithë i kemi parë pamjet e afrikanëve të mbetur në mëshirë të fatit në barkat e peshkimit në det, që i nxjerrin pastaj rojet kufitare italiane, malteze apo spanjolle.

Askush nuk e di sa njerëz ilegalë jetojnë në Europë. Sipas llogarive të Komisionit European kjo shifër mund të jetë rreth

4.5 milion.

Bashkimi European po bën përpjekje të mëdha për të ndaluar imigrimin ilegal. Këtu përfshihen kontrole më të rrepta në kufijtë e jashtëm dhe bashkëpunim më i mirë me vendet e origjinës. Në të njëjtën kohë po bëhen përpjekje intensive për t'u dhënë qytetarëve jo europianë mundësi legale për të shkuar dhe për të jetuar në BE. Nëpërmjet bashkëpunimit për zhvillim me vendet më të varfra të botës, BE po përpjeket të ndihmojë në përmirësimin e kushteve të jetesës në vendet e tyre të origjinës, me qëllim që atyre të mos u duhet të imigrojnë.

## BE dhe partnerët e saj të bashkëpunimit

► BE mban marrëdhënie me shumë vende të botës, përfshirë kontakte të gjera me vendet në zhvillim në Afrikë dhe Amerikën Latine dhe me vende të vogla e të mëdha të Azisë. Këtu ne nuk kemi mundësi të flasim për këto marrëdhënie të ndryshme, por ju mund të gjeni më shumë në faqen e internetit: [http://Europa.eu/pol/cfsp/index\\_en.htm](http://Europa.eu/pol/cfsp/index_en.htm)


Një vëmendje të veçantë në politikën e jashtme BE-ja i kushton politikës së zhvillimit me vendet e Grupit të Shteteve të Afrikës, Karaibeve dhe Pacifikut (ACP). Marrëveshje të partneritetit ekonomik po nënshkruhen me 79 shtete të ACP, me qëllim që të ndihmohen këto vende për t'u integruar në eko-

nominë globale dhe për të marrë masa efektive në luftën kundër varfërisë në vendet e tyre.

Bashkimi European dhe shtetet e tij anëtare janë donatorët më të mëdhenj në botë në ndihmën për zhvillim. Kjo përbën më shumë se gjysmën e parave që marrin këto vende. Sigurisht që politika e zhvillimit përfshin jo vetëm furnizimin me ujë të pastër dhe rrugë të shtruara, ndonëse ato janë të rëndësishme. BE-ja nxit gjithashtu zhvillimin nëpërmjet tregëtisë, duke hapur tregjet e tij për eksportet nga vendet në zhvillim dhe duke i inkurajuar ato të rritin tregëtinë midis tyre.

## BE-ja – bashkëpunimi për zhvillim

Këtu ka fusha të ndryshme të bashkëpunimit të BE-së për zhvillimin. Ju lutemi përshtatni numrat e fotografive me tekstet e shkruara që lidhen me masat e politikës së zhvillimit. Kujdes se shkrimet dhe masat mund të mos jenë pranë njëra-tjetrës.



Nr	Teksti	Nr	Masat
<input type="checkbox"/>	Mbështetje për infrastrukturën me ambulanca në Afrikë	<input type="checkbox"/>	Përkrahja e të drejtave të njeriut dhe demokracisë
<input type="checkbox"/>	Trajnimi i punonjësve të pyjeve në Papua Guinea e Re	<input type="checkbox"/>	Zhvillimi i infrastrukturës
<input type="checkbox"/>	Furnizim me oriz në portin e Zanzibarit për shpërndarje njerëzve në nevojë	1	Përkrahje për energjinë e rinovueshme / furnizimin me energji
<input type="checkbox"/>	Heqja e minave tokësore në Laos	<input type="checkbox"/>	Furnizim me ujë
<input type="checkbox"/>	Ndërtimi i puseve në Daka, Bangladesh	<input type="checkbox"/>	Zgjidhje konflikti/paqeruatje
<input type="checkbox"/>	Grante për kredi të vogla punonjësve të veshjeve në Bosnjë dhe Herzegovinë	<input type="checkbox"/>	Përkrahje për shëndetësinë
1	Prodhimi i energjisë elektrike nga era, Bolivi	<input type="checkbox"/>	Mbrojtja e mjedisit
<input type="checkbox"/>	Vëzhgimi i zgjedhjeve në Nigeri	<input type="checkbox"/>	Masa për rritjen ekonomike
<input type="checkbox"/>	Mbështetje për shkollat, në Eterasamanë rajonin Chapare të Bolivisë	<input type="checkbox"/>	Sigurimi i arsimit bazë për të gjithë
<input type="checkbox"/>	Ndërtim rruge në Benin	<input type="checkbox"/>	Zhdukja e varfërisë

## Diskutim

### Diskutim për migrimin

Rreth 214 milion njerëz në botë jetojnë në një vend që nuk është shtëpia e tyre. A mund të imagjinoi gjithashtu që t'i kthenit kurrizin vendit tuaj përgjithmonë? Çfarë arsyesh mund të kishit ju për ta bërë këtë? Pse do të shkonit në një vend tjetër ku nuk të duan dhe madje të pengojnë që të hysh? Diskutojini në grupe. Gjejini arsyet që shtynë njerëzit të shkojnë në BE, nga jugu dhe nga lindja, dhe silleni këtë informacion në grup për diskutim.

## Europa dhe bota në përgjithësi

- ▶ Europa nuk është një ishull por pjesë e një bote që rritet së bashku çdo ditë e më tepër. Prandaj BE-ja ka përgjegjësi të angazhohet në shkallë ndërkombëtare. Ajo e bën këtë për të ruajtur interesat e saj, për të ushtruar një ndikim pozitiv në zhvillimin global dhe për të ndihmuar popujt e tjerë që nuk bëjnë një jetë aq të mirë e të sigurtë sa europianët.

Për shembull, BE-ja është e përfishirë seriozisht në mbrojtjen e klimës dhe përpiqet të bindës vendet e tjera që lëshojnë sasi të mëdha dioksidi karboni në atmosferë, të angazhohen në një strategji të përbashkët. E kemi fjalën për vende si SHBA dhe Kina. Çështje të tjera në mbrojtje të mjedisit luajnë gjithashtu një rol të madh dhe mund të zgjidhen vetëm në bashkëpunim. Shembujt janë ndotja dhe peshkimi i shfrenuar në oqeanë.

BE-ja promovon demokracinë në të gjithë botën dhe përpiqet të ushtrorë influencën e saj për të bindur vendet e tjera të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore demokratike dhe t'ua sigurojnë ato qytetarëve të tyre.

BE-ja po punon aktivisht për arritjen e qëllimeve të Mijëvjeçarit, të cilat synojnë në thelb të përgjysmojnë varfërinë deri në vitin 2015. Është fjala për njerëzit që kanë më pak se 1 dollar amerikan në ditë për të jetuar.

Europa nuk mund të kontrollojë e vetme fatin e planetit tonë, por edhe pa Europën asgjë nuk mund të ndryshojë. Ne jetojmë në një botë, në të cilën nuk mund të jetojmë mirë kur të tjerët janë duke luftuar.

# E ardhmja e Europës



'Ku doni të shkoni për të jetuar në vitin 2030 dhe çfarë do të donit të bëni?'

Bashkimi European është më shumë se një grupim ekonomik. BE-ja është komunitet vlerash, pra një grupim shtetesh dhe qytetarësh, që ndajnë bindje themelore dhe jetojnë me to. Shumë nga problemet e shekullit të 21-të janë të ndryshme nga ato të shekullit të 20-të. Midis shteteve anëtare është vendosur paqja dhe armiqësitë e vjetra janë kthyer në miqësi të qëndrueshme ose të paktën në partneritete paqësore. Por BE-ja ka përpara detyra të reja, të cilat duhen trajtuar, nëse duam të ruajmë vlerat themelore për qytetarët e Europës në shekullin e ri.

## Ushtrim

### Viti 2030 dhe unë

Ku doni të shkoni për të jetuar në vitin 2030 dhe çfarë do të donit të bëni?

Secili do t'i përgjigjej ndryshe kësaj pyetjeje. Por realizimi i ëndërrave tuaja varet jo vetëm nga aftësitë tuaja personale dhe fati i mirë, por edhe nga situata politike.

Më 2030 unë do të doja të jetoja në \_\_\_\_\_ dhe të punoja si \_\_\_\_\_

Unë e shoh kështu situatën time personale:

Për të arritur këto qëllime, unë dua sa më poshtë nga politikanët e vendit tonë:

Ja çfarë dua unë nga politikëbërësit Europeanë sot:

## Europa në botën e globalizuar

► Është e qartë se ekonomitë e vendeve Europiane përballen me sfida të mëdha. Këto vijnë pjesërisht nga globalizimi, pikërisht nga shtrirja e ekonomisë së tregut për të mbuluar pjesë të mëdha të botës. Mallrat, kapitalet, idetë dhe informacioni kalojnë kufijtë shumë shpejt, ato gjenden kudo dhe krijojnë konkurrencë botërore.

Kjo krijon ngatërresa të drejtpërdrejta për ne: për një kompani në Francë, nuk ka rëndësi se çfarë ofrojnë konkurentët e saj brenda vendit apo edhe në Spanjë. Asaj i duhet të dijë gjithashtu se me çfarë çmimi prodhohet

në Kinë, në SHBA apo në Indi dhe të jetë në gjendje t'i kundërvihet këtij çmimi duke ofruar çmimet e saj më të lira, ose duke prodhuar mallra që janë më të shtrenjta, por të ofruara me cilësi më të mirë.

Nga ana tjetër, kushtet tona të jetesës ndryshojnë për arsye që nuk kanë fare të bëjnë me globalizimin. Qytetarët rriten, edhe shoqëritë plaken. E para është gjë shumë e mirë, sepse do të thotë që njerëzit jetojnë më gjatë. Por kjo do të thotë gjithashtu që kostua për kujdesin shëndetësor rritet dhe pensionet duhet të paguhet për

një kohë më të gjatë.

Në të njëjtën kohë, dhe kjo nuk është një gjë e mirë, numri i lindjeve është në rënie. Në dekadat e fundit shumë popuj kanë zgjedhur të kenë familje më të vogla ose fare pa fëmijë. Kjo krijon gjithashtu një problem ekonomik sepse sa vjen dhe ka më pak të rinj, që duhet të mbështetin gjithnjë e më shumë njerëz të moshuar.

## Bashkimi European i së ardhmes

Sot bëhen shumë diskutime brenda BE-së dhe shteteve anëtare si do të jetë BE-ja në të ardhmen. Shumë njerëz debatojnë për të ardhmen e Europës. Për këtë natyrisht që mendojnë edhe politikanët kryesorë të BE-së. Ja disa shembuj. Ju lutemi analizojini ato dhe pastaj diskutojini dhe jepni mendimin tuaj.

### 1. José Manuel Barroso

Fjala e Presidentit të Komisionit Evropian mbajtur në Dialogun e disa organizatave jo-qeveritare — ‘Gjendja e BE-së më 2013: Shkon drejt federalizmit apo fragmentimit?’ Bruksel, më 22 prill 2013:



‘Jam dakord që, nganjëherë, kur Europa shpesh duket se qëndron midis integritetit dhe fragmentimit, ne duhet të jemi të qartë për planet tona politike, alternativat dhe synimet. Kjo është një zgjedhje thelbësore që ne duhet të bëjmë nëse duam që ideja Europiane dhe vlerat Europiane të realizohen, si brenda ashtu edhe jashtë kufijve tanë.

Unë për veten time nuk kam patur frikë të përdor fjalën e ndaluar: federalizëm. Së pari, është tamam kuptimi i kundërt i asaj që shumë njerëz dyshojnë ose kanë frikë. Federata nuk është një supershtet, por një federatë demokratike e shteteve që mund të trajtojnë problemet tona të përbashkëta, duke ndarë sovranitetin në mënyrë që çdo vend dhe çdo qytetar të jenë të pajisur më mire për të kontrolluar fatin e tyre. Kjo nënkupton se duhet të pranohet qartë se ne nuk mund ta bashkojmë Europën kundër shteteve anëtare, atë duhet ta ndërtojmë në bashkëpunim me shtetet anëtare. Unë besoj në një Europë ku popujt janë krenarë për vendet e tyre, por krenarë gjithashtu që janë europianë, dhe krenarë për vlerat tona europiane.

Bashkimi European, si e njohim sot, tanimë ka një numër elementësh federative të pamohueshëm: një Komision European mbinacional me një mandat

që të çojë përpara interesin e përgjithshëm europian, një Parlament European të zgjedhur drejtpërdrejt, një Bankë Qëndrore Europiane të pavaruar dhe një Gjykatë Europiane të Drejtësisë të mbështetur në një sistem ligjor që ka përparësi mbi ligjin kombëtar. Këto institucione kanë pushtet mbinacional, që ka ardhur duke u rritur.

Kjo ndarje e pushtetit midis nivelit qendror dhe shteteve përbërës nuk është e ngurtësuar dhe do të jetë gjithmonë e diskutueshme dhe e kundërshtueshme. Madje në shtetet federale të krijuar, që nga SHBA e deri tek Gjermania, ka një debat të vazhdueshëm për çështje të tjera, si p.sh. ç’mund të bëjë dhe ç’duhet të bëjë qeveria federale, deri ku shkon dhe ku duhet të shkojë pushteti i saj.

Besoj se në dekadat e ardhëshme Bashkimi European do të shohë më mirë përpara dhe do të jetë më largpamës.

Ai do të jetë një instrumenti fuqishëm për qytetarët europianë dhe shtetet anëtare për të bashkuar përpjekjet e tyre në përshtatjen ndaj globalizimit dhe mbrojtjen e vlerave tona të përbashkëta. Bota po ndryshon shumë dhe shtetet anëtare së bashku mund të luajnë një rol shumë të madh. Vetëm së bashku dhe me institucione më të fuqishme do të mundim të përballojmë sfidat e krizës ekonomike dhe financiare, të mungesës të burimeve dhe të ndryshimit të klimës, të situatës në botë për varfërinë dhe prapambetjen. Së bashku do të krijojmë kushte më të mira për të mbrojtur vlerat tona të përbashkëta dhe për të ruajtur, ndërkohë që bëjmë reforma, modelin tonë, ekonominë tonë sociale të tregut dhe tiparet tona më të rëndësishme të mënyrës europiane të jetesës.’

*Burimi:* [http://europa.eu/rapid/press-release\\_SPEECH-13-346\\_en.htm](http://europa.eu/rapid/press-release_SPEECH-13-346_en.htm)

### 2. Martin Schulz

Presidenti i Parlamentit European, ka shkruar në një libër për Bashkimin European:



‘Jam i bindur se Europa duhet të afrohet më shumë së bashku nëse nuk do të fundoset. Kur kjo del nga goja e një politikani europian, kjo mund të mos çuditë shumë njerëz – fundi fundit publiku shpesh është lodhur nga predikimet se komuniteti është si një xhiro me biçikletë: po të mos u japim pedaleve, biçikleta do të përmbysset. Por unë nuk them këtë. Integrimi europian jo patjetër duhet të shtrihet më tej për të parandaluar përmbysjen e BE-së. Është krejtësisht e mundur të mendojmë një situatë që mund të pranohet si një pikë e fundit e qëndrueshme e bashkimit. Por ne ende nuk e kemi arritur këtë situatë. Rritja e bashkëpunimit që unë kam parasysh bazohet në pranimin e matur se nuk kemi bërë punën e duhur në disa vende, ndërsa ndërtojmë godinën europiane. Për shembull, ne kemi monedhë të përbashkët, por jo politikë fiskale e financiare të përbashkët. Kjo do të shkonte keq dhe tani tregjet e dëgjuaara aq shumë tregojnë çdo ditë si ndonjëherë Europeanët i kundërvihen njëri-tjetrit për shkak të atij gabimi. Ne kemi bërë gabime edhe në politikën e shpenzimeve. Në vend që të investonim në fushat që sjellin rritje, subvencionojmë mbushjen e gropave për të mbajtur gjallë artificialisht industritë e vjetra. Po kaq keq është zhurma në politikën e jashtme dhe të sigurisë që na bëjnë qesharakë në politikën ndërkombëtare.





Jello: 'Vendos vetë, përgjigju dhe diskuto rezultatet në klasë.'

Para së gjithash ne na duhet edhe një qartësim institucional afatmesëm në BE, sepse edhe specialistët tani e kanë të vështirë të dallojnë kompetencat specifike të Presidentit të Parlamentit European, të Presidentit të Komisionit dhe të Presidentit të Këshillit European. Ajo që na duhet urgjentisht është një qeveri e vërtetë Europiane, e zgjedhur dhe e mbikqyrur nga parlamenti.'

*Burimi: (Martin Schulz: Der gefesselte Riese: Europas letzte Chance, Berlin 2013)*

### 3. Herman Van Rompuy

Në një fjalim në Kopenhagë, Presidenti i Këshillit European foli lidhur me fitimin e besimit të qytetarëve:



'Krizja e bankave dhe publikut ka prekur besimin e publikut në forcën e ekonomive tona. "A mund të mbetet Europa një kontinent tërheqës e konkruer në një botë që ndryshon kaq shpejt? Ka edhe një ankth për projektin. A mund të ofrojë Bashkimi European përgjigjen e duhur?" Është fakt që të gjitha ekonomitë tona

duhet t'i përshtaten botës që ndryshon.

Që të mbetemi konkruer, ne europianët duhet të punojmë më shumë, më mirë, të ndryshojmë dhe të jemi krijues, sepse ne nuk mund t'ia dalim më që të jetojmë jashtë mundësive tona. Reforma duhen bërë, me ose pa BE-në. Defiçiti publik prej 15% dhe një borxh publik prej 160% të PBB nuk janë të përballueshme, me BE-në apo pa BE-në. Konkurrenca e ekonomive tona duhet të rritet me BE-në apo pa të.

Por në sytë e publikut, edhe kur vendimet janë marrë nga drejtuesit kombëtare, faji shpesh bie mbi Bashkimin. E vërteta është se ne nuk kemi ndryshuar në kohë të mira ose jo sa duhet, kështu që na duhet të ndryshojmë në kohë të ►



Si do ishte? Një video që tregon si do të ishte jeta jonë nëse Bashkimi European nuk do të ekzistonte. Videoja mund të gjendet këtu:  
[http://bit.ly/Debate\\_Europe](http://bit.ly/Debate_Europe)

► këqija. Por megjithatë ne jemi më mirë duke ndryshuar së bashku! Të gjithë udhëheqësit politikë të Europës e dinë këtë dhe veprojnë sipas rrethaneve, sikundër unë e shoh në çdo mbledhje të nivelit të lartë. Por si mund t'i bindim ne qytetarët? Kjo është sfida kryesore.

Vendet e punës, rritja dhe kushtet para-prake, stabiliteti politik dhe financiar; këto janë elementët kryesorë për të rikthyer besimin e popullit: besimin në forcën dhe aftësitë ripërtëritëse të ekonomive të Europës dhe besimin e tyre në projektin european. Edhe njëherë, të dyja janë të lidhura ngushtësisht.

Ka edhe një mënyrë tjetër për politi-

kanët për të rifituar besimin e publikut. Udhëheqësit duhet të thonë të vërtetën.

Një e vërtetë e tillë është që ndikimi i reformave në rritjen dhe vendet e punës duan kohë. Diçka tjetër, përgjigjia përfundimtare për krizën nuk varet nga krijimi i instrumentave financiarë (fondet dhe obligacionet), por nga ndryshimet në ekonominë reale. Dhe akoma, kostoja e pjesës jo Europiane do të ishte e papërballueshme.

Ata që pretendojnë se vendi i tyre do t'ia dalë me forcat e veta, jo vetëm që i kanë iluzione, por mashtrojnë! Populizmi dhe nacionalizmi nuk mund të japin përgjigje për sfidat e kohës sonë. Politi-

kanët duhet të tregojnë hapur çfarë rreziqesh ka. Ata gjithashtu duhet të tregojnë qartë e me zë të lartë cilat janë bindjet e tyre europiane. Si mund të kërkosh që të mbrohet kauza europiane kur vetë udhëheqësit nuk kanë kurajon të mbrojnë dhe të çojnë përpara integrimin european? Kaq e thjeshtë është puna. Neve na duhet politika europiane, por edhe një gjuhë europiane.'

(“Përtej institucioneve: Përse Europa sot?” Fjala e Herman Van Rompuy, President i Këshillit European, në Konferencën Europa në Kopenhagë, 11 maj 2012.)

*Burimi:* [http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms\\_data/docs/pressdata/en/ec/130149.pdf](http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/en/ec/130149.pdf)

# Dhe tani është radha JUAJ.

- Si i shikoni ju gjërat? Zhvillimi i Bashkimit European prek veçanërisht brezin e ri, i cili do të ndërtojë jetën e tij në shekullin e 21-të. Çfarë dëshironi ju? Çfarë është e rëndësishme për ju?

Merrni si bazë pikëpamjet e udhëheqësve europianë për të trajtuar këto pyetje. Secili të bëjë listën e vet të përparësive. Cilat janë tre çështjet më të rëndësishme për ju? Dhe cilat tre gjërat që ju nuk i doni.

Lista mund të ishte kështu:

Unë sigurisht e dua:	Unë kategorikisht nuk e dua:
1.	1.
2.	2.
3.	3.

Krahasoni përparësitë tuaja me njëri-tjetrin dhe diskutoni çfarë Europe doni ju.

Ja disa sugjerime: Si duhet të jetë BE-ja nëse duhet të marrë përsipër gjithë këto sfida? Mendoni për gjërat që diskutuat më parë në ushtrimin për monedhën e përbashkët ('Kush duhet të vendosë për monedhën e përbashkët?' faqe28).

## Masa

- BE-ja duhet të jetë më e madhe. Duhet të ketë më shumë vende sesa sot për të përballuar peshën e nevojshme.
- BE-ja nuk duhet të ketë anëtarë të tjerë sepse do të bëhej shumë e ndryshme dhe do të humbiste aftësinë për të vepruar.
- BE-ja duhet të zvogëlohet. Për të forcuar kohezionin, vendet që nuk duan të zhvillojnë BE-në më tej duhet të largohen.

## Përgjegjësitë

- BE-ja duhet të sigurojë më shumë të drejta nga shtetet anëtare në mënyrë që të veprojnë me efektivitet, që do të thotë që të merren më shumë vendime nga qendra në Bruksel dhe Strasburg për të gjithë BE-në.
- BE-ja duhet t'i përmbahet ndarjes aktuale të përgjegjësive midis vetes dhe shteteve anëtare, sepse ajo është e balancuar.
- BE-ja duhet t'u kthejë përgjegjësitë shteteve anëtare dhe të përqëndrohet në çështjen thelbësore, në funksionimin e tregut të vetëm. Mbrojtja e mjedisit, mbrojtja e konsumatorit dhe politika e jashtme duhet t'i marrin përsipër shtetet anëtarë.

## Ushtria

- BE-ja duhet të krijojë një ushtri të veçantë europiane për t'u dhënë një forcë nevojave të saj dhe për të qenë në gjendje të ndër marrë veprime ushtarake.
- BE-ja është një forcë civile dhe duhet të qëndrojë larg çështjeve ushtarake.

- BE-ja të ruajë bashkëpunimin me NATO-n dhe të përdorë forcat e saj goditëse vetëm në aksione të kufizuar ku NATO nuk është e interesuar.

## Vendim-marrja

- Në BE vendimet duhet të merren vetëm nga Parlamenti European sepse anëtarët e tij janë zgjedhur nga të gjithë ne.
- Në BE vendimet duhet të merren bashkërisht nga Këshilli i Bashkimit European dhe Parlamenti European.
- Vendimet e rëndësishme duhet të merren me një referendum të gjerë european brenda ditës në gjithë BE-në.

## Procedura e votimit

- Vendimet në BE përgjithësisht duhet të merren me shumicë votash, sepse gati 30 shtete rrallë bien dakord dhe vetëm pas diskutimesh të gjata.
- Në BE, në përgjithësi vendimet duhet të merren unanimisht, sepse asnjë shtet nuk përjashtohet.
- Në BE, për çështjet e përditëshme vendimet merren me shumicë votash, ndërsa për çështjet parimore merren unanimisht, me qëllim për të krijuar një balancë të mirë midis efektivitetit dhe konsideratës për të gjithë.

## Euro-ja

- Sa më shumë vende pranojnë euro-n si monedhë të tyre, aq më afër bashkohet Europa. Prandaj ne duhet të nxisim sa më shumë vende që të pranojnë monedhën e përbashkët dhe t'i ndihmojmë ato financiarisht kur duhet.
- Vetëm vendet që pranojnë kushtet e

bashkimit monetar duhet të jenë anëtarë të zonës së euro-s. Ato duhet të monitorohen vazhdimisht për zbatimin e rregullave.

- Një monedhë e përbashkët nuk është e mirë për Europën. Është e qartë se veçanërisht në periudhë krize, BE-ja nuk mund të bjerë dakord për një politikë konsekuente. Një politikë financiare dhe monetare nacionale vepron më shpejt dhe më mirë. Prandaj BE-ja duhet të kthehet në monedhat kombëtare, të cilat nuk e përjashtojnë bashkëpunimin.

## Vendet e punës

- Bashkimi European duhet të krijojë vende pune në mënyrë aktive. Projektet e infrastrukturës të financuara nga BE-ja, sidomos ato ndërkombëtare, si ndërtimi i rrugëve dhe urave për lidhjen e vendeve anëtare të BE-së, do të krijojnë më shumë vende pune.
- Vendet anëtare e dinë vetë si t'i krijojnë vendet e tyre të punës. Vetë BE-ja nuk ka pse të shqetësohet për këtë.
- Aktualisht nuk ka nevojë të krijohen vende pune, ne kemi mjaft vende bosh në Europë. Me lëvizjen e lirë dhe me një informacion më të mirë, ata që kërkojnë punë mund t'i gjejnë ato shumë shpejt.

# Bashkimi i qytetarëve



► Sikundër e kemi parë, qytetarët e Europës përfaqësohen në BE nga Parlamenti Europian.

Parlamenti Europian zgjidhet për 5 vjet nga të gjithë ata që kanë të drejtë vote në Bashkimin Europian. Votohet në moshën 18 vjeç, në Austri edhe 16. Mosha e votimit pasiv ndryshon midis shteteve anëtare. Ndërsa në Finlandë, Danimarkë apo Gjermani, për shembull, mund të zgjidhesh në Parlamentin Europian 18 vjeç, në Lituani, Poloni dhe Mbretërinë e Bashkuar duhet të jesh 21. Në Qipro, Itali ose Greqi duhet të jesh 25 vjeç që të zgjidhesh në PE. Qytetarët e BE-së që banojnë në një vend tjetër të BE-së (p.sh. austriakët në Hungari) mund të votojnë atje. Parlamenti është një faktor i rëndësishëm vendim marrës në politikën Europiane. Parlamenti së bashku me Kë-shillin përbëjnë legjislativin për Bashkimin Europian. Kjo do të thotë se asgjë nuk ndodh në Europë pa Parlamentin Europian

Megjithëse Parlamenti Europian ka funksione të rëndësishme dhe përfaqëson drejtpërdrejt qytetarët, interesimi në zgjedhjet Europiane është relativisht i ulët. Influenca e Parlamentit Europian është rritur dukshëm prej vitit 1979. Parlamenti thotë fjalën e vet në shumë e shumë çështje. Por ndonëse Parlamenti ka shumë ç'të thotë në krahasim me 30 vjet më parë, pjesëmarrja në zgjedhjet ka rënë. Mesatarisht në gjithë BE-në vetëm 43% e zgjedhësve kanë votuar në zgjedhjet e vitit 2009.



## Ushtrim

### Përse pjesëmarrja e zgjedhësve është kaq e ulët?

Diskutoni mendimet dhe idetë tuaja në një grup të vogël dhe pastaj pyesni njerëzit me të drejtë vote më 2009, si prindërit, të njohurit apo njerëz të rrugës nëse kanë votuar në zgjedhjet e Parlamentit Europian. Nëse jo, pse?

Mblidhni rezultatet në një pllakat dhe jepni argumentet 'pro dhe kundër pjesëmarrjes në votim' krahas krahas në tavolinë. A mund të mendoni për argumente të tjera? I shtoni ato.

# Bashkimi European — një aleancë me një të ardhme

- Bashkimi European u krijua pas Luftës së Dytë Botërore me qëllim që të zëvendësonte shekujt e armiqësisë midis vendeve Europiane me miqësinë e bashkëpunimin.

Tani pas 50 vjetësh është e drejtë të thuhet se ky qëllim është arritur. Sigurisht ende ka paragjykime të ndërsjella, por askush nuk kërcënon njeri me luftë.. Ndryshimet në opinionet qarkullojnë në sallat e konferencave dhe përgjithësisht zgjidhen me një kompromis që të gjitha vendet e përfshira mund ta pranojnë.

Kështu që Bashkimi European e ka arritur qëllimin e tij fillestar të sigurimit të paqes midis shteteve anëtare. Por kjo nuk mbaron me kaq sepse vlerat që ai

mbron janë në fuqi.

Europa ka përpara sfida të reja, si p.sh. shmangia e ndryshimit të klimës apo luftëa kundër terrorizmit ndërkombëtar. Është plotësisht e qartë se asnjë vend i veçuar european nuk mund t'i trajtojë këto probleme vetëm. Por bashkërisht ne jemi gjysmë miliardi njerëz të edukuar dhe me një ekonomi të fuqishme prapa nesh. Së bashku ne mund të arrijmë diçka. Bashkimi European na ndihmon ne të rregullojmë jetën tonë sipas dëshirave tona.

Sigurisht do të ketë gjithmonë diskutime dhe argumente se ç'rrugë do të marrë BE-ja në të ardhmen.

Nuk ka zgjidhje magjike dhe idetë e shteteve të ndryshme anëtare dallojnë së tepërmi.

Pra BE-ja është një 'punë në progres'; është një institucion që ndryshon. Në rast se zhvillohet në drejtimin që qytetarët e Europës mendojnë se është e drejtë, atëherë ata duhet të përfshihen. Hapi i parë është pjesëmarrja në zgjedhjet për Parlamentin European. Sa më e madhe të jetë pjesëmarrja, aq më shumë Parlamenti mund të bëjë që pikëpamjet dhe ndikimi i tij të ndjehen.

## Europa dhe ne

- Një mënyrë e mirë për të njohur Parlamentin European është të ftoni në shkollën tuaj një anëtar të PE-së dhe ta pyesni atë. Sigurisht që një diskutim me një Anëtar të Parlamentit European nuk është e vetmja rrugë të mësoni për Europën.

'Ne shpresojmë se ju e keni gjetur këtë broshurë interesante. Po të doni të mësoni më shumë ne kemi mbledhur disa këshilla në faqen tjetër.



# Këtu janë disa këshilla për gjëra për t'i lexuar ose për t'i bërë nëse doni të dini më shumë për Europën.

- **Këndi i fëmijëve.**  
Lojëra dhe pyetje-përgjigje për Europën për fëmijët dhe rininë:  
Faqe interneti: <http://europa.eu/kids-corner>
- **Këndi i mësuesve.**  
Material didaktik mbi BE-në dhe aktivitetet e tij:  
Faqe interneti: [http://europa.eu/teachers-corner/index\\_en.htm](http://europa.eu/teachers-corner/index_en.htm)
- **Portal i rinisë Europiane.**  
Faqe europiane dhe nacionale për arsimin, vendet e punës, udhëtimet dhe plot informacione të tjera për rininë:  
Faqe interneti: [http://europa.eu/youth/EU\\_en](http://europa.eu/youth/EU_en)
- **Europa Direct.**  
Qendra informacioni të BE-së në gjithë Europën. Mund të pyesni në telefon ose e-mail, ose të vizitoni qendrën afër jush.  
[http://europa.eu/europedirect/meet\\_us](http://europa.eu/europedirect/meet_us)
- **Historia e Bashkimit Europian.**  
Informacione dhe video mbi baballarët themelues të BE-së:  
Faqe interneti: [http://europa.eu/about-eu/eu-history/index\\_en.htm](http://europa.eu/about-eu/eu-history/index_en.htm)
- **Europa juaj.**  
Ndihmë dhe këshilla për qytetarët e BE-së dhe familjet e tyre:  
Faqe interneti: [http://europa.eu/youreurope/citizens/index\\_en.htm](http://europa.eu/youreurope/citizens/index_en.htm)
- **Debat mbi të ardhmen e Europës.**  
Portal informacioni mbi debatet europiane:  
Faqe interneti: <http://ec.europa.eu/debate-future-europe/>

## Ushtrim

### Klikoni në adresat e mësipërme të Internetit.

Për të bërë këtë ndahuni në grupe. Secili grup duhet të marrë një adresë interneti dhe të gjejë çfarë lloj informacioni dhe sugjerimesh përmban ai. Çfarë ju pëlqeu në ato faqe dhe çfarë nuk ju pëlqeu? Pastaj ua paraqitni ato të tjerëve. Kështu, secili shikon një gjë, por i mëson të gjitha.

Kalofshi mirë!

# Pika kontakti me BE-në



## ONLINE

Informacione në të gjitha gjuhët e Bashkimit Europian mund të gjeni në faqen e internetit Europa: [europa.eu](http://europa.eu)



## PERSONALISHT

Në mbarë Europën ka qindra qendra lokale informative të BE-së. Adresën e qendrës më të afërt mund ta gjeni në faqen e internetit Europe Direct: [europedirect.europa.eu](http://europedirect.europa.eu)



## PËRMES TELEFONIT OSE POSTËS

**Europe Direct** është një shërbim që u përgjigjet pyetjeve tuaja mbi Bashkimin Europian. Këtë shërbim mund ta kontaktoni në telefonin pa pagesë **00 800 6 7 8 9 10 11** (disa operatorë të telefonave celular nuk lejojnë hyrjen në numrat 00800 ose janë me pagesë), ose me pagesë nga jashtë BE-së **+32 22999696**, ose nëpërmjet postës elektronike në: [europedirect.europa.eu](http://europedirect.europa.eu)



## LEXONI MBI EUROPËN

Për të lexuar botimet mbi BE-në, duhet të klikoni vetëm një herë në faqen e internetit të librisë së BE-së: [bookshop.europa.eu](http://bookshop.europa.eu)



## NË SHQIPËRI

Ju mund të gjeni informacion dhe broshura mbi Bashkimin Europian në:

### Delegacioni i Bashkimit Europian në Shqipëri

ABA Business Center, Rr. Papa Gjon Pali II, kati 17  
Tiranë, Shqipëri  
Faqja e Internetit :  
[www.eeas.europa.eu/delegations/albania](http://www.eeas.europa.eu/delegations/albania)  
Telefon: +355 (0)4 222 8320 ose 223 0871 –  
222 8479 – 223 4284  
Fax: +355 (0)4 223 0752  
E-mail: [delegation-albania@eeas.europa.eu](mailto:delegation-albania@eeas.europa.eu)

### ndiq Delegacionin e BE në:

Portal: [www.eudalbania.eu](http://www.eudalbania.eu)  
Facebook: [www.facebook.com/eu.delegation.albania](https://www.facebook.com/eu.delegation.albania)  
Twitter: [www.twitter.com/eu\\_albania](https://www.twitter.com/eu_albania)

### Qendra e Informimit të BE-së në Tiranë

Rr. "Ismail Qemali", Nr. 32  
Tiranë, Shqipëri  
Faqja e Internetit: [www.euinfocentre.al](http://www.euinfocentre.al)  
E-mail: [info@euinfocentre.al](mailto:info@euinfocentre.al)  
Telefon & Fax: +355 (0)4 226 1767

### Qendra e Informimit të BE-së në Shkodër

Rr. "Kolë Idromeno" (Pedonale), Nr. 63  
Shkodër, Shqipëri  
Faqja e Internetit: [www.shkodra.euic.al](http://www.shkodra.euic.al)  
Telefon & Fax: + 355 (0)22 254 552

### Qendra e Informimit të BE-së në Vlorë

Bulevardi "Ismail Qemali", Vlorë, Shqipëri  
Faqja e Internetit: [www.vlora.euic.al](http://www.vlora.euic.al)  
Telefon & Fax: +355 (0)33 408 688

### Ministria e Integritimit Europian

Ministria e Integritimit  
Rr. "Papa Gjon Pali II", Nr. 3  
Kutia Postare Nr. 8302  
Tiranë, Shqipëri  
Faqja e Internetit: <http://integrimi.gov.al>  
Telefon: +355 (0)4 222 8623, 08000809  
Fax: +355 (0)4 222 8623  
E-mail: [info@integrimi.gov.al](mailto:info@integrimi.gov.al)

### Projekti i Mbështetjes së Proçesit të Integritimit në BE (SMEI 3)

Ministria e Integritimit  
Rr. "Papa Gjon Pali II", Nr. 3  
Tiranë, Shqipëri  
Telefon: +355 (0)4 223 6790 / 6741  
Faqja e Internetit: <http://smei3.mie.gov.al/en/pages/Home>  
E-mail: [info@smei3.com](mailto:info@smei3.com)

Komisioni Europian dhe Parlamenti Europian ka Përfaqësi dhe zyra në të gjitha vendet e Bashkimit Europian. Bashkimi Europian gjithashtu ka delegacione në pjesët e tjera të botës.

# Europa: Përse bëhet fjalë në përgjithësi?

'Europa ndodhet diku gjetkë.' Kjo deklaratë provokative hap kapitullin e parë të kësaj broshure. Natyrisht kjo nuk është e vërtetë. Duke qenë në qendër të Europës, ne natyrisht kemi shumë pyetje ç'është Europa dhe çfarë bën ajo. P.sh. kush drejton Europën? Çfarë bën Bashkimi European për jetën tone të përditshme? Ku është koka e kontinentit në një botë të globalizuar? Cila është e ardhmja e Europës? Të gjitha këto pyetje dhe të tjera gjenden në këtë broshurë. Ajo është bërë për nxënës të moshës midis 13 dhe 18 vjeç dhe u jep atyre mundësinë për të lexuar, për të mësuar dhe diskutuar çështjet në mënyrë bashkëvepruese. Broshura shoqërohet nga një udhërrëfyes për mësuesit.



Vëndet anëtare të Bashkimit European (Korrik 2013)



Vëndet kandidate dhe kandidate të mundshme



Zyra e Publikimeve

ISBN 978-92-79-29207-1



9 789279 292071